



AGJENCIA PËR MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

RAPORT

VJETOR

2023



AGJENCIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Raport vjetor për vitin 2023

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

RAPORT VJETOR 2023

Periudha e raportimit: 2023

Buxheti i përgjithshëm: 17.305.000,00 denarë

Numri i të punësuarve: 20

www.azlp.mk

Personi përgjegjës:

Emri dhe mbiemri: Imer Aliu

Titulli: Drejtor

E-mail: info@privacy.mk

Telefon: 02/3230-635



Përmbajtja

1.	PËRMBLEDHJE	5
2.	HYRJE	6
3.	STATUSI, UDHËHEQËSIA, KOMPETENCAT DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE	7
3.1	Statusi	7
3.2	Udhëheqësia	7
3.3	Kompetencat	7
3.4	Struktura organizative	8
4.	AKTIVITETET E REALIZUARA NGA KOMPETENCAT LIGJORE, PLANI I PUNËS DHE PLANI STRATEGJIK	10
4.1	Rekomandime nga Bashkimi Evropian dhe realizimi i prioriteteve urgjente të reformave	10
4.2	Aktivitetet për harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian	10
4.3	NPAA – Programi nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian	11
4.4	Supervizione	11
4.4.1	Supervizione të rregullta	11
	<i>Njësitë e vetëqeverisjes lokale</i>	<i>11</i>
	<i>Operatorët elektronikë</i>	<i>12</i>
4.4.2	Supervizione në fushën e ndjekjes së komunikimeve	12
4.4.3	Supervizione të jashtëzakonshme	13
	<i>Supervizionet e jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare</i>	<i>13</i>
	<i>Supervizionet në bazë të njoftimeve të dorëzuara për cenime të sigurisë së të dhënave personale</i>	<i>13</i>
	<i>Mbajtja e letërnjoftimeve dhe dokumenteve të udhëtimit në hotele gjatë regjistrimit të mysafirëve në librin e mysafirëve</i>	<i>14</i>
	<i>Video mbikëqyrja në lokalet që ndodhen në qendrat tregtare</i>	<i>14</i>
	<i>Supervizionet e jashtëzakonshme në bazë të kërkesave të parashtruara nga persona fizikë</i>	<i>14</i>
	<i>Miratimi i kredive të shpejta online</i>	<i>14</i>
	<i>Qasja dhe përdorimi i adresave të postës elektronike të ish-të punësuarve</i>	<i>15</i>
	<i>Mbajtja e e letërnjoftimit në hotel gjatë regjistrimit në librin e mysafirëve</i>	<i>15</i>
4.4.4	Kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje	15
4.4.5	Procedura për kundërvajtje	16
4.4.6	Konteste administrative	17
4.4.7	Kërkesa të tjera nga persona fizikë	18
4.4.8	Cenimi i sigurisë së të dhënave personale	18
4.4.9	Programi vjetor i supervizionit për vitin 2024	18
4.5	Harmonizimi i rregullores sektoriale	19
4.5.1	Mendime, konsultime, sugjerime organeve të pushtetit qendror dhe organeve shtetërore	19
4.5.2	Njoftime, udhëzime, përgjigje, sugjerime dhe urdhëresa të dhëna kontrolluesve, përpunuesve	20
4.5.3	Trajtim të parashtrësive	21
4.5.4	Parashtrësia në lidhje me rrjetet sociale	21
4.5.5	Lëshimi i miratimeve për përpunimin e të dhënave personale	22
4.6	Qasje e lirë deri te informatat me karakter publik	22
4.7	Marrëdhëniet me publikun	22
4.7.1	Bashkëpunimi me media	24
4.7.2	Komunikimi me palët	25
4.8	Njoftimi për përpunimin e të dhënave personale me rrezik të lartë	25
4.9	Zyrtarët (Oficerët) për mbrojtjen e të dhënave personale	25
4.10	Trajnime të realizuara	25
4.11	Transferimi i të dhënave personale në vende të tjera	26
5.	AKTIVITETET PËR PËRMIRËSIMIN E KUALITETIT TË PUNËS	27
6.	BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TJERA DHE BASHKËPUNIMI NDERKOMBËTAR	28
6.1	Bashkëpunimi me institucionet e tjera	28
6.2	Bashkëpunimi Ndërkombëtar	29
	<i>Bashkëpunimi me autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale nga rajoni</i>	<i>29</i>
6.3	Pjesëmarrja e Agjencisë në ngjarje ndërkombëtare, konferenca që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale	29
6.4	Projektet dhe ndihma e huaj	30
7.	PUNA FINANCIARE	32
7.1	Realizimi i buxhetit për vitin 2023 – LLOGARIA lloji 637	32
7.2	Realizimi i buxhetit për vitin 2023 – LLOGARIA lloji 631	32
8.	KONKLUSIONE	33
9.	REKOMANDIME	34



10. SHTOJCAT	36
Shtojca nr. 1: Organogrami i Agjencisë deri më 31 Dhjetor 2023	36
Shtojca nr. 3: Struktura e të punësuarve sipas gjinisë	37
Shtojca nr. 4: Struktura e të punësuarve sipas moshës	37
Shtojca nr. 5: Struktura sipas nivelit të arsimit	37
Shtojca nr. 6: Struktura sipas llojit të arsimit	37
Shtojca nr. 7: Struktura sipas titujve të nëpunësve administrativë dhe personave të emëruar/të zgjedhur	38
Shtojca nr. 8: Struktura sipas kategorive të titujve dhe personave të emëruar/zgjedhur	38
Shtojca nr. 9: Supervizione	38
Shtojca nr. 10: Supervizione sipas sektorëve të rregullta, të jashtëzakonshme dhe kontrolluese	38
Shtojca nr. 11: Supervizione sipas fushave	39
Shtojca nr. 12: Supervizionet e jashtëzakonshme sipas mënyrës së parashtrimit të tyre	39
Aneksi nr. 13: Lista e propozim- ligjeve, akteve nënligjore dhe materialeve të tjera për të cilat është dhënë mendim	39
Aneksi nr. 14 : Lista e propozim-ligjeve që i janë dorëzuar Agjencisë për konsultim paraprak	40
Shtojca nr. 15: Lista e sugjerimeve për organet e pushtetit qendror në lidhje me dispozitat dhe instrumentet e tjera ligjore	40
Shtojca nr. 16: Trajtimi i parashtrësave	41
Shtojca nr. 17: Mënyra e paraqitjes së peticioneve	41
Shtojca nr. 18: Parashtrimet sipas llojit të rrjeteve sociale	41
Aneksi nr. 19: Regjistrimi i zyrtarëve (oficerëve) të rinj për mbrojtjen e të dhënave personale sipas vitit	41
Shtojca nr. 20: Pasqyrë e trajnimeve të realizuara nga Agjencia	42
Shtojca nr. 21: Mendime /rekomandime të dhëna në lidhje me transferimin e të dhënave personale në vende të tjera	42
Shtojca nr. 22: Fletëparaqitjet për transferimin e të dhënave personale në BE dhe Zonën Ekonomike Evropiane	42
Shtojca nr. 23: Kërkesa të pranuar për miratimin e transferimit të të dhënave personale	42
Shtojca nr. 24: Mendimet, pyetjet dhe njoftimet për transferimin e të dhënave personale	43
Shtojca nr. 25: Buxheti dhe shpenzimet për vitin 2023	43
Shtojca nr. 26: Struktura e buxhetit të miratuar për vitin 2023	44
Shtojca nr. 27: Tabela krahasuese e buxhetit të miratuar për vitin 2023 me buxhet të miratuar për vitin 2022 (në denarë)	44
Shtojca nr. 27-a: Paraqitje grafike	45
Shtojca nr. 26: Pasqyrë e realizimit të mjeteve financiare sipas zërave në vitin 2023	45
Shtojca nr. 28-a: Paraqitje grafike	46
Shtojca nr. 29: Realizimi i buxhetit për vitin 2022 - LLOGARIA lloji 631	46
Shtojca nr. 30: Pasqyrë e realizimit të mjeteve financiare sipas zërave në vitin 2023	47
Shtojca nr. 31: Buxheti i miratuar i të hyrave të parashikuara për vitin 2023	47
Shtojca nr. 32: Pasqyrë e realizimit të mjeteve financiare sipas zërave në vitin 2023	48



1. PËRMBLEDHJE

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Agjencia) në bazë të nenit 70 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale i dorëzon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut Raportin vjetor për punën e vitit 2023, në të cilin prezantohen të gjitha aktivitetet e ndërmarra gjatë vitit 2023, me synim ngritjen dhe përforcimin e mëtejshëm të nivelit të mbrojtjes së të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit, veçanërisht në lidhje me supervizionet e kryera, udhëzimet e dhëna si dhe pasqyrë të hapave të ndërmarra për harmonizimin e legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe instrumentet ligjore të Këshillit të Evropës në këtë fushë.

Në shkurt 2023, kanë kaluar tre vite nga miratimi i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale i cili transponon Rregullativën (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Mbrojtjen e Personave Fizik në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe për shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC (Rregullativa e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale).

Fokusi i Agjencisë në vitin 2023 ishte ngritja e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale mes personave fizik, zyrtarëve (oficerëve) për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe kontrolluesve dhe përpunuesve të sektorit publik dhe privat. Zbatimi i suksesshëm i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale qëndron në kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore që vlejné për kontrolluesit dhe përpunuesit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të kuptuarit e personave fizikë për të drejtat dhe mundësitë e realizimit të tyre. Në këtë kontekst, Agjencia ka filluar edhe përgatitjen e Strategjisë së re për mbrojtjen e të dhënave personale (2024-2030).

Gjatë vitit 2023, Agjencia në kontinuitet ka kryer detyrat dhe kompetencat e saj, me theks të veçantë në kompetencat hetimore (supervizionet), gjatë së cilës janë parashtruar gjashtë kërkesa për inicim të procedurës për kundërvajtje, dhe në bazë të këtyre kërkesave janë shqiptuar sanksione kundërvajtëse në shumë të përgjithshme prej 1.554.811 denarë.

Për sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin me Bashkimin Evropian, procesi për miratimin e Ligjit që do të transponojë Direktivën (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 27 Prill 2016 (Direktiva e Policisë) është ende aktiv dhe Agjencia vazhdon të sugjerojë për nevojën e miratimit të tij.

Agjencia gjatë vitit 2023, ka vazhduar gjithashtu të promovojë dhe zhvillojë ndërgjegjësimin për nevojën e mbrojtjes së të dhënave personale gjatë proceseve të digjitalizimit të shërbimeve dhe harmonizimit të legjislacionit sektorial.

Prandaj, Raporti përfshinë edhe rekomandimet kryesore për periudhën e ardhshme që i referohet zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në drejtim të harmonizimit të vazhdueshëm të kontrolluesve dhe përpunuesve me të, si dhe forcimin e statusit të pavarur të Agjencisë, si parakusht themelor për harmonizimin e plotë të legjislacionit të Bashkimit Evropian.



2. HYRJE

Korniza ligjore dhe institucionale në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale përcaktohet me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale i cili transponon Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sepse mbrojtja e të dhënave personale është njëra ndër vlerat themelore të çdo shoqërie demokratike dhe pasqyrim i nivelit të të drejtave të njeriut që respektohen dhe zbatohen.

Agjencia, si pjesë e ekipit negociator, ishte e përfshirë drejtpërdrejt në procesin e skringut i cili u mundëson vendeve candidate të njoftohen me trashëgiminë ligjore të Bashkimit Evropian dhe në këtë mënyrë t'i përgatisin ato për negociatat e anëtarësimit. Sipas raportit të skringut, Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të përfundojë rishikimin e kornizës ligjore në mënyrë që të arrihet pajtueshmëri e plotë me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Raporti theksoi se numri i vogël i të punësuarve në Agjenci ka një ndikim serioz negativ në zbatimin e ligjit dhe pengon aftësinë e Agjencisë për të kryer në mënyrë efektive detyrat e saj. Gjithashtu, duhet të konsultohet në mënyrë më sistematike për ligjet sektoriale apo legjislacionin zbatues, në drejtim të dhënies së mendimeve për aktet ligjore, edhe kur të konsultohet Agjencia, këshillat e dhëna nuk ndiqen gjithmonë.

Në këtë kuadër, në mars të vitit 2023, Komisioni Evropian realizoi Mision vlerësues organeve të pavarura dhe rregullatore në Maqedoninë e Veriut, si pjesë e procesit të skringut. Në rekomandimet e Misionit vlerësues drejtuar Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndër të tjera u theksua se Kuvendi duhet të shqyrtojë më thellë thelbin e Raportit vjetor të Agjencisë dhe të ndjekë rekomandimet e dhëna.

Më tej, udhëzimet e dhëna në Udhërrëfyesin për sundimin e ligjit, i cili përfshin reformat kryesore në Kapitullin 23 – drejtësia dhe të drejtat themelore dhe Kapitulli 24 – drejtësia, liria dhe siguria si dhe lidhet me procesin e skringut, gjithashtu i referohen miratimit të ndryshimeve të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale për harmonizim të plotë me Rregulloren evropiane në lidhje me rregullimin e rregullave për transferimin e të dhënave personale dhe forcimin e pavarësisë dhe autonomisë së Agjencisë.

Në këtë kontekst, duke kuptuar nevojën për harmonizim të plotë me rregulloren evropiane, Agjencia përgatiti Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili është ende në proces të miratimit.

Prandaj,

MISIONI i Agjencisë vazhdon të mbetet përforcimi, promovimi dhe mbrojtja e privatësisë dhe i të dhënave personale të personave fizik, përmes realizimit të supervizioneve, dhënies së udhëzimeve si dhe mendimeve në përputhje me dispozitat ligjore,

Ndërsa

VIZIONI është që ajo të jetë një mbrojtëse dhe promovuese e njohur e së drejtës së privatësisë së personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale, me një ekip të motivuar të gatshëm për t'iu përgjigjur sfidave të epokës digjitale.



3. STATUSI, UDHËHEQËSIA, KOMPETENCAT DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE

3.1 Statusi

Agjencia është organ i pavarur shtetëror, kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra në përpunimin e të dhënave personale në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale.

Agjencia ka kompetenca këshilluese, korigjuese, mbikëqyrëse dhe hetuese në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

3.2 Udhëheqësia

Agjencia udhëhiqet nga drejtori, i cili zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë rizgjedhje, njëkohësisht drejtori ka zëvendës të tij.

3.3 Kompetencat

Agjencia, si kreator kryesor i politikave, masave dhe veprimeve që duhen ndërmarrë për zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale në nivel nacional, ka këto përgjegjësi ligjore:

- të kryejë supervizion mbi mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e aktiviteteve që ndërmerren gjatë përpunimit të të dhënave personale në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale;
- të ndjek dhe realizon zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të promovon ndërgjegjësimin publik dhe pikëpamjen e rrezeve, rregullat, masat mbrojtëse dhe të drejtat në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, veçanërisht të aktiviteteve që synojnë fëmijët;
- në përputhje me ligjin, të jep mendime Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe institucioneve dhe organeve të tjera për masat legjislative dhe administrative për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;
- të promovon ndërgjegjësimin e kontrolluesve dhe përpunuesve për detyrimet e tyre;
- me kërkesë, i siguron informata çdo subjektin të të dhënave personale në lidhje me ushtrimin e të drejtave të tij sipas këtij ligji dhe nëse është e nevojshme, për atë qëllim bashkëpunon me organe të tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të shqyrton kërkesat e parashtruara nga subjekti i të dhënave personale ose nga shoqata në përputhje me këtë ligj dhe hulumton me masë adekuate lëndën e kërkesës, si dhe në afat të arsyeshëm e informon parashtruesin e kërkesës për rezultatin e procedurës, veçanërisht nëse është e nevojshme hulumtim shtesë ose koordinim me organ tjetër mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të bashkëpunon me organe tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe shkëmbimin e informatave dhe ndihmës së ndërsjellë, me qëllim që të sigurohet mbrojtje e të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;
- të hulumton në lidhje me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë edhe informatat e marra nga ndonjë organ tjetër mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale ose organ tjetër publik;
- të monitoron zhvillimin adekuat, veçanërisht në fushën e teknologjisë informatike dhe komunikimit dhe praktikën tregtare, nëse ajo ndikon në mbrojtjen e të dhënave personale;
- të miraton klauzola kontraktuese standarde;



- të vëndon dhe mban listë në lidhje me kërkesën për vlerësim të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale;
- të jep mendime për operacionet e përpunimit të të dhënave personale;
- të nxitë përpilimin e kodekseve të sjelljes, jep mendime dhe miraton kodekset e sjelljes që ofrojnë masa mbrojtëse të përshtatshme në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të nxitë krijimin e mekanizmave për certifikim për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të vulave dhe shenjave për mbrojtjen e të dhënave personale;
- kur është e zbatueshme, të ushtron kontrollim të certifikave të lëshuara në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të publikon standardet dhe normativat për akreditim të trupit për monitoring të kodekseve të miratuara të sjelljes dhe të trupit certifikues në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të akrediton trupin për monitoring të kodekseve të miratuara të sjelljes;
- të jep leje për klauzolat kontraktuese gjatë transferimit të të dhënave personale;
- të miraton rregullat e obligueshme korporative;
- të vendos dhe mban evidencë të shkeljeve, si dhe të masave të ndërmarra në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të realizon trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale; dhe
- të kryen detyra të tjera lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me ligj.

3.4 Struktura organizative

Agjencia deri më 31.12.2023 ka të punësuar gjithsej 20 persona (drejtor, 15 nëpunës administrativë, 2 persona staf teknik ndihmës dhe 2 persona të punësuar me afat të caktuar). Kjo paraqet 38 % të plotësisimit të vendeve të punës sipas vendeve të sistematizuara në Agjenci, duke marrë parasysh faktin se në Aktin për sistematizimin e vendeve të punës janë paraparë 47 vende pune me gjithsej 50 realizues.

Organizimi i brendshëm përbëhet nga 4 sektorë me 9 njësi dhe 1 njësi të veçantë. Plani vjetor i punësimit të Agjencisë për vitin 2023 është kthyer për rishikim nga Ministria e Financave në tri raste – nuk është marrë mendim pozitiv ndërsa në planin vjetor të katërt të punësimit Agjencia nuk ka kërkuar punësime të reja, por vetëm 6 avancime, edhe pse në vitet e fundit ka pasur dalje të konsiderueshme të të punësuarve nga Agjencia.

Duhet theksuar se gjatë vitit 2023, me kërkesë të dy nëpunësve administrativë ju është ndërpre punësimi në Agjenci - 1 udhëheqësit njësie -supervizor (me arsim të lartë në fushën e shkencave juridike) dhe 1 bashkëpunëtori të ri -arkivist (me arsim të lartë nga fusha e administratës publike).

Prandaj, ngelë fakti se Agjencia ka mungesë të theksuar të burimeve njerëzore dhe se kjo sfidë duhet të zgjidhet si me plotësimin e një pjese të vendeve të punës, ashtu edhe duke avancuar kuadrin ekzistues, por edhe duke siguruar autonomi dhe pavarësi të plotë, veçanërisht në menaxhim e burimeve njerëzore.


Në tremujorin e parë të vitit 2023, për shkak të ngarkesës së shtuar të punës në Agjenci, Ministria e Financave ka dhënë vetëm pëlqim për punësimin e dy personave për një periudhë të caktuar kohore për një periudhë njëvjeçare.

Prandaj, prioritet për periudhën e ardhshme do të jetë punësimi i kuadrove të reja profesionale dhe vazhdimi i procesit të avancimit të nëpunësve ekzistues në tituj më të lartë, si dhe pavarësimi i plotë i Agjencisë në pjesën e menaxhimit me burimet njerëzore.

Gjithashtu, sfidë do të jetë sigurimi i mjeteve financiare për punën e Agjencisë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut që do të paraqesë pasqyrë reale të Agjencisë, i cili në formë propozimi dorëzohet në Ministrinë e Financave, me çka do të sigurohet realizim i plotë dhe profesional i kompetencave të saja ligjore. Pasqyre e detajuar në lidhje me organizimin e



brendshëm (organogram) dhe strukturën e të punësuarve sipas: përfaqësimit të drejtë, gjinisë, strukturës së moshës, nivelit të arsimit, llojit të arsimit, titujve dhe kategorive të niveleve të nëpunësve administrativ, është dhënë në pjesën Shtojcat si *shtojca nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.*





4. **AKTIVITETET E REALIZUARA NGA KOMPETENCAT LIGJORE, PLANI I PUNËS DHE PLANI STRATEGJIK**

4.1 **Rekomandime nga Bashkimi Evropian dhe realizimi i prioriteteve urgjente të reformave**

Agjencia, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, është në proces të përgatitjes së një Strategjie të re për periudhën 2024-2030, si një dokument që jep drejtim dhe përcakton rrugët për modernizimin dhe zhvillimin e sistemit të mbrojtjes së të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Propozim Strategjia do të zhvillohet përmes instrumentit TAEKS, i cili ofron ndihmë të ekspertëve nga BE-ja.

Ngelë që në periudhën e ardhshme të miratohet edhe ligji që do të transponojë Direktivën (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 Prill 2016 (Direktiva e Policisë), në mënyrë që të plotësohet harmonizimi normativ me ligjin e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

4.2 **Aktivitetet për harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian**

Aktivitetet për harmonizimin e legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me legjislacionin e Bashkimit Evropian në masë të madhe koincidojnë me rekomandimet dhe prioritetet reformuese për harmonizimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe zbatimin e plotë të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Qëllimi i miratimit të Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale është tejkalimi i vërejtjeve të shënuara në Raportin e skringut për Republikën e Maqedonisë së Veriut të vitit 2023, Raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2023, Raportin e Misionit vlerësues për organet e pavarura dhe rregullatore në Maqedoninë e Veriut të Komisionit Evropian për vitin 2023 dhe Udhërrëfyesi për sundimin e ligjit. Në këto raporte është theksuar se Agjencia kryen detyra dhe kompetenca më të mëdha të krijuara me Ligjin e ri, por mungesa e vazhdueshme e stafit në Agjenci ka një ndikim serioz negativ në zbatimin e ligjit. Funkcionimi i plotë i Agjencisë në masë të madhe varet nga Ministria e Financave (MF) dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), në kuptimin që për punësimin e personelit, Agjencia ka nevojë për miratim nga MF, ndërsa për avancim në detyrë të personelit dhe rishikimit të strukturës organizative, ka nevojë për miratimin e MSHIA si dhe në lidhje me mjetet shtetërore të caktuara për Agjencinë, të cilat mjaftojnë vetëm për të mbuluar funksionet bazë, pa hapësirë për investime në zhvillimin profesional të stafit. Miratimi i Propozim ligjit do të mundësojë që Agjencia të ketë të gjitha burimet e nevojshme për kryerjen efektive të funksioneve dhe kompetencave të saj, në mënyrë që të theksohet funksionimi i saj i pavarur, autonom dhe i paanshëm siç parashikohet në Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e Personave.

Brenda këtyre kornizave, Agjencia ka nevojë për sjelljen e Strategjisë së re për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbetet nevojë e madhe për ngritjen e mëtejshme të ndërgjegjësimit dhe inkurajimin e kulturës së mbrojtjes së të dhënave personale në të gjithë sektorët.

Harmonizimi i legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me legjislacionin e Bashkimit Evropian në masë të madhe varet nga fillimi i procesit të miratimit të ligjit të ri për transpozimin e Direktivës (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 Prill 2016 (Direktiva e Policisë) nga Ministria e Drejtësisë, e cila do të mbetet prioritet për vitin 2024.



4.3 NPAA – Programi nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian

Programi nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) është një dokument gjithëpërfshirës afatgjatë që përcakton dinamikën e miratimit të së drejtës së BE-së, drejtimit strategjike, politikat, reformat, strukturat, resurset dhe afatet që duhen zbatuar në mënyrë që Republika e Maqedonisë së Veriut të plotësojë kushtet për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në gusht 2021, filloi zbatimi i plotë i tij i parashikuar në Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore të Programit Nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA). Aktivitetet e mëtejshme të parashikuara në Programin Nacional dhe të zbatuara nga Agjencia, janë zbatimi i plotë i akteve nënligjore të miratuara, kryerja e supervizioneve, krijimi i ekipit të trajnuar dhe të motivuar dhe rritjen e ndërgjegjësimit të personave fizik për të drejtat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

4.4 Supervizione

Nëpërmjet zbatimit të supervizioneve të rregullta të jashtëzakonshme dhe kontrolluese, Agjencia përcakton nëse kontrolluesit dhe përpunuesit kryejnë përpunimin e të dhënave personale në mënyrë ligjore dhe të drejtë dhe nëse në raste konkrete janë shkelur të drejtat e personave fizik.

Në këtë raport janë përfshirë aktivitetet kryesore të punës së Sektorit për supervizion në vitin kalendarik 2023, të cilat rrjedhin nga fusha e kompetencave kyçe të Agjencisë.

Në vitin 2023 janë kryer gjithsej 237 supervizione, që është 39,4% më shumë në krahasim me vitin 2022 dhe përkundër zvogëlimit të numrit të supervisorëve (katër (4) supervisorë për të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut).

Realizimi i 237 supervizioneve sipas llojit ishin:

- 27 supervizione të rregullta dhe
- 210 supervizione të jashtëzakonshme.

Nga supervizionet e realizuara:

- 34 supervizione janë kryer te kontrolluesit e sektorit publik,
- 195 supervizione te kontrolluesit e sektorit privat dhe
- 8 te personat fizik.

4.4.1 Suprvizione të rregullta

Gjatë vitit 2023 janë kryer 27 supervizione të rregullta në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe operatorët elektronikë.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale

Supervizioni i rregullt te njësitë e vetëqeverisjes lokale (gjithsej 21 supervizione (1 në Qytetin e Shkupit dhe 20 në komuna) sipas vëllimit ishin të pjesshme, ndërsa në fokus të supervizionit janë përfshirë

- menaxhimi me sistemin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe llogaridhënies,
- trajnimi dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe
- menaxhimi dhe angazhimi i subjekteve të jashtme (përpunuesve).

Në njësitë e qeverisjes lokale, supervizioni identifikoi një nivel shumë të kufizuar sigurie se proceset dhe procedurat për mbrojtjen e të dhënave personale janë në zbatim. Shumica e komunave nuk kishin të caktuar zyrtar (oficer) për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Aty ku kishin të caktuar zyrtarë (oficer) për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk ishin përfshirë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale në kohën e duhur. Gjithashtu, zyrtarët (oficerët) për



mbrojtjen e të dhënave personale nuk e kanë kryer punën e tyre në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kontrolluesit (komunat) nuk kishin miratuar dhe nuk kishin zbatuar procedura për menaxhimin me përpunues dhe as nuk kishin lidhur kontrata me përpunuesit në pajtim me nenin 32 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu u konstatua se kontrolluesit nuk kanë kryer kontrole në punën e përpunuesve.

Sa i përket pjesës së trajnimit dhe ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të dhënave personale, u kontrollua nëse janë siguruar dhe nëse është mundësuar ndjekja e trajnimeve për mbrojtjen e të dhënave personale të të punësuarve dhe sa janë ata të vetëdijshëm për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre që kanë me kontrolluesit. Supervizioni identifikoi nivel shumë të kufizuar sigurie që të punësuarit para fillimit të punës të njihen me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me dokumentacionin e miratuar për masat teknike dhe organizative dhe se janë edukuar sipas kompetencave të tyre. Kështu, u konstatua se të gjithë kontrolluesit nuk kishin përpiluar plan për edukimin e menaxhmentit dhe personave të autorizuar për përgjegjësitë dhe detyrimet e drejtpërdrejta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nuk kishin ofruar trajnime të përgjithshme dhe të specializuara për mbrojtjen e të dhënave personale të zyrtarit (oficerit) për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të punësuarve, sipas dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale.

Operatorët elektronikë

Te gjashtë (6) kontrolluesit nga fusha e komunikimeve elektronike, janë përfshirë proceset që kanë të bëjnë me sistemin e krijuar për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe obligimet e operatorëve në procedurën për zbatimin e aktiviteteve në përputhje me dispozitat për ndjekjen e komunikimeve.

4.4.2 Supervizione në fushën e ndjekjes së komunikimeve

Gjatë vitit 2022, Agjencia ka kryer supervizione të rregullta te kontrolluesit të cilët veprojnë në përputhje me dispozitat për ndjekjen e komunikimeve (Agjencia e Sigurisë Kombëtare, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes – Shërbimi i Sigurisë dhe Inteligjencës Ushtarake, Administrata e Policisë Financiare, Drejtoria e Doganave, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, 22 prokuroritë themelore publike, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe 17 gjykata themelore) të cilat ishin planifikuar sipas Programit vjetor të supervizioneve për vitin 2022.

Në këtë kontekst, në fillim të vitit 2023, Agjencia ka kryer supervizione të rregullta te kontrolluesit – operatorë të cilët kanë detyrime sipas dispozitave për ndjekjen e komunikimeve (Telekomi i Maqedonisë SHA Shkup, Shoqëria për shërbime të komunikimit A1 Maqedoni SHPKNJP Shkup, Shoqëria për shërbime të komunikimit LLAJKAMOBALJLL SHPKNJP Shkup, Shoqëria për telekomunikacione dhe shërbime NEOTEL SHPK eksport-import Shkup dhe Shoqëria për shërbime telekomunikuese TELEKABELL SHPKNJP Shtip), të cilat ishin planifikuar sipas Programit vjetor për kryerjen e supervizioneve për vitin 2023.

Gjatë supervizionit, Agjencia ka aplikuar një pyetësor të standardizuar për ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale dhe aplikimit të masave për mbrojtjen e të dhënave personale, përmes të cilit është vlerësuar funksionimi i sistemit të krijuar për mbrojtjen e të dhënave personale te kontrolluesit - operatorët.

Për këto supervizione të rregullta janë përpiluar procesverbale dhe janë sjellë aktvendime me të cilat kontrolluesit – operatorët detyrohen me masa korrigjuese me qëllim të zbatimit të plotë të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në korrelacion me dispozitat e Ligjit për ndjekjen e komunikimeve.

Njëkohësisht, për këto supervizione të kryera, në përputhje me dispozitat e nenit 70 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me dispozitat e neneve 35 dhe 54 të Ligjit për



ndjekjen e komunikimeve, Agjencia ka dorëzuar te Komisioni për mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut Raport të posaçëm për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit për ndjekjen e komunikimeve, i cili paraqet gjendjen te organet e autorizuar, gjykatat, operatorët dhe Agjencia Teknike - Operative nga aspekti i zbatimit të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe në korrelacion me dispozitat e Ligjit për ndjekjen e komunikimeve dhe Ligjit për procedurë penale.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, përfaqësues nga Agjencia ka marrë pjesë në tri punëtori praktike me temë „Zhvillimi i procedurave për ruajtjen dhe asgjësimin e të dhënave të mbledhura me masa të veçanta hetimore”, organizuar nga DCAF – Qendra e Gjenevës për menaxhimin e sektorit të sigurisë (ku morën pjesë edhe përfaqësues nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Themelore Penale në Shkup, Prokuroria Themelore Publike Shkup, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuar, Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Oda e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe profesorë universitarë) me qëllim të zhvillimit dhe përpilimit të Udhëzuesit për asgjësimin e të dhënave të mbledhura me masa të posaçme hetimore dhe në përrputhje me rekomandimet e dhëna nga Agjencia në kuadër të supervizioneve të kryera në fushën e ndjekjes së komunikimeve.

4.4.3 Supervizione të jashtëzakonshme

Supervizionet e jashtëzakonshme me të drejtë janë supervizione të paparalajmëruara dhe kryhen në raste të parashtrimit të kërkesës në përrputhje me dispozitat e neneve 93, 97 dhe 100 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me iniciativë të parashtruar nga organi shtetëror, personi juridik ose fizik, në bazë të detyrës zyrtare ose në rast dyshimi të supervizorit në lidhje me shkeljet e dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në vitin 2023, supervizorët kanë kryer 210 supervizione të jashtëzakonshme, përkatësisht:

Supervizionet e jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer 155 supervizione sipas detyrës zyrtare. Shtatë (7) supervizione të jashtëzakonshme janë iniciuar pas njoftimeve të dorëzuara për cenim të sigurisë së të dhënave personale. Supervizionet e mbetura të jashtëzakonshme janë kryer te kontrolluesit në fushën e turizmit dhe hotelerisë, tregtisë, kulturës dhe argëtimit, financave, komunikimeve elektronike dhe postave.

Supervizionet në bazë të njoftimeve të dorëzuara për cenime të sigurisë së të dhënave personale

Supervizorët kanë kryer shtatë (7) supervizione në bazë të njoftimeve të dorëzuara për cenime të sigurisë së të dhënave personale në vitin 2022 dhe 2023. Në katër raste, të gjitha nga sektori publik, cenimi ka ndodhur si rezultat i sulmeve me ransomver. Në të shtatë rastet është konstatuar shkelje të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale, më konkretisht është konstatuar se kontrolluesit:

- nuk kanë zbatuar masat e duhura teknike dhe organizative, përkatësisht nuk kanë miratuar politika për sistemin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe procedura të tjera të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për masa teknike dhe organizative.
- nuk kanë miratuar procedurë për cenimin e sigurisë së të dhënave personale si dhe për menaxhimin e incidenteve.
- nuk kanë caktuar administrator të sistemit të informacionit.
- të punësuarit e kontrolluesve nuk kanë nënshkruar deklarata për të garantuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e përrpunimit të të dhënave personale.



- të punësuarit e kontrolluesve nuk kanë marrë autorizime për përpunimin e të dhënave personale.
- nuk kanë miratuar dhe zbatuar Plan për edukimin e menaxhmentit dhe personave të autorizuar për detyrimet dhe përgjegjësitë e drejtpërdrejta për mbrojtjen e të dhënave personale.
- nuk kanë kryer kontrole periodike për të monitoruar përputhjen e veprimeve të tyre me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.
- nuk kanë kryer kontroll të brendshëm të sistemit të informacionit dhe infrastrukturës së informacionit për të kontrolluar nëse procedurat e aplikuara janë në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.
- nuk kanë caktuar zyrtar (oficer) për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nuk kanë publikuar kontaktet e zyrtarit (oficerit) për mbrojtjen e të dhënave personale në faqen e tyre të internetit.
- nuk kanë mbajtur evidencë për aktivitetet e përpunimit.
- nuk kanë përmbushur detyrimin për sigurinë e përpunimit të të dhënave personale.
- nuk kanë sistem të krijuar për dokumentimin e cenimeve të sigurisë së të dhënave personale, duke përfshirë faktet që lidhen me cenimet e sigurisë së të dhënave personale, pasojat e tyre dhe veprimet e ndërmarra për të trajtuar cenimin.
- nuk kanë kryer vlerësim të rrezikut.

Mbajtja e letërnjoftimeve dhe dokumenteve të udhëtimit në hotele gjatë regjistrimit të mysafirëve në librin e mysafirëve.

Agjencia ka kryer katër (4) supervizione të jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare të kontrolluesit nga fusha e turizmit dhe hotelerisë (hotele në Shkup), ku është kontrolluar mbajtja e letërnjoftimeve dhe dokumenteve të udhëtimit gjatë regjistrimit të mysafirëve në librin e mysafirëve. Gjatë këtyre spervizioneve nuk janë konstatuar shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Video mbikëqyrja në lokalet që ndodhen në qendrat tregtare

Grupi i dytë i supervizioneve të kryera sipas detyrës zyrtare, të cilat ishin me numër më të madh gjithsej **140** supervizione kishin për qëllim kontrollin e gjendjes së sistemit të vendosur për video mbikëqyrje, në lidhje me detyrën e kontrolluesve për të vendosur njoftim për kryerjen e video mbikëqyrjes dhe mënyra e ushtrimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, të dhënat e të cilave përpunohen nëpërmjet sistemit të video-mbikëqyrjes, gjegjësisht nëse është miratuar dhe theksuar Deklaratë për privatësi për kryerjen e video mbikëqyrjes. Gjithashtu, është kontrolluar nëse kontrolluesit kanë njoftuar Agjencinë për kontaktet e zyrtarit (oficerit) për mbrojtjen e të dhënave personale. Në shumicën e këtyre kontrolluesve janë konstatuar shkelje të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe janë dhënë afate dhe masa për respektimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Supervizionet e jashtëzakonshme në bazë të kërkesave të parashtruara nga persona fizik

Gjatë vitit 2023 janë kryer **36** supervizione të jashtëzakonshme në bazë të kërkesave të parashtruara për shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Miratimi i kredive të shpejta online

Në njërën nga kompanitë financiare janë kryer gjashtë (**6**) supervizione për dhënien e kredive online (të shpejta). Në të gjitha rastet parashtruesit janë ankuar se kontrolluesi-shoqëria financiare për dhënien e kredive të shpejta ka aprovuar kredi online pa paraqitur kërkesë për kredi, pra ka miratuar kredi për persona të tjerë fizikë që kanë përdorur të dhënat e tyre



personale duke përdorur numra telefoni që nuk janë të tyre dhe pa përcaktuar identitetin e tyre gjatë paraqitjes së kërkesave për kredi. Në dy (2) nga gjashtë rastet, kredia është aprovuar përmes ndërmjetësit të kredisë (dyqan online). Në të gjitha rastet, supervizorët kanë konstatuar shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, përkatësisht kanë konstatuar se kontrolluesi i përpunon në mënyrë të paligjshme të dhënat personale të aplikantëve sepse nuk demonstroi se si i ka mbledhur të dhënat e tyre personale, të cilat janë përdorur në kërkesën për kredi, në bazë të së cilës është lidhur kontrata e kredisë, me të cilën kontrolluesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Për katër raste janë paraqitur padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në të gjitha rastet, Gjykata Administrative ka nxjerrë aktgjykime me të cilat vërtetohen aktvendimet e Agjencisë.

Qasja dhe përdorimi i adresave të postës elektronike të ish-të punësuarve

Në vitin 2023, në Agjenci janë parashtruar dy kërkesa nga qytetarët për shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me qasjen dhe përdorimin e e-mail adresave të tyre zyrtare pas përfundimit të marrëdhënies së punës. Dy kërkesat janë parashtruar kundër kontrolluesve të ndryshëm. Në të dyja rastet, supervizorët konstatuan shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe urdhëruan kontrolluesit të fshinin e-mail adresat e ish-të punësuarve.

Mbajtja e e letërnjoftimit në hotel gjatë regjistrimit në librin e mysafirëve

Agjencia ka kryer supervizion të jashtëzakonshëm te një kontrollues (hotel) për shkak të mbajtjes së kartës së identitetit të parashtruesit gjatë qëndrimit të tij në hotel. Kontrolluesi ruante çdo ditë dokumentet personale të mysafirëve deri në daljen e tyre dhe ata ishin garanci për të kryer pagesën për shërbimet e ofruara nga hoteli. Agjencia ka konstatuar shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Agjencia ka kryer supervizione të jashtëzakonshme me iniciativë të dorëzuar nga organi shtetëror, person juridik apo fizik në 19 raste. Numri më i madh i iniciativave (14) janë iniciuar nga persona fizikë për shkak të vendosjes së video-mbikëqyrjes në disa objekte banimi pa siguruar pëlqimin e 70% të banorëve/qiramarrësve.

4.4.4 Kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje

Gjatë vitit 2023, supervizorët kanë dorëzuar gjashtë (6) kërkesa për inicimin e procedurës kundërvajtëse ndaj dy kontrolluesve nga sektori privat në Komisionin për kundërvajtje në Agjenci.

Katër (4) kërkesa janë paraqitur kundër një shoqërie financiare për lëshimin e kredive (të shpejta) online, pasi në kundërshtim me nenin 10 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ka përpunuar në mënyrë të paligjshme të dhënat personale të aplikantëve dhe nuk ka demonstruar se në cilën mënyrë ka mbledhur të dhënat e tyre personale dhe të cilat janë përdorur në kërkesat për kredi, në bazë të të cilave janë lidhur marrëveshje kredie, që përbën kundërvajtje sipas nenit 111 paragrafi (1) pika 2 dhe nenit 111 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Një kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse është parashtruar ndaj një kontrolluesi nga fusha e turizmit dhe hotelerisë, sepse në kundërshtim me nenin 9 paragrafi (1) alinetë 1, 2 dhe 3 dhe nenin 10 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa në lidhje me dispozitat e nenit 9 paragrafët (2) dhe (3) të Ligjit për letërnjoftimet dhe dispozitat për veprimtari të hotelerisë dhe i mbanin letërnjoftimet e mysafirëve (subjekte të të dhënave personale) pas regjistrimit të tyre në librin e mysafirëve deri në largimin e tyre, i cili është shkelje në pajtim me nenin 111 paragrafi (1) pika 1 dhe 2 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave



personale dhe nenit 111 paragrafi (2), ndërsa në lidhje me nenin 111 paragrafi (2) pika 20 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndaj të njëjtit kontrollues është parashtruar edhe një kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje, pasi në kundërshtim me nenin 106 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk ka lejuar supervisorët dhe personin e autorizuar nga Agjencia të kryejnë supervizion të jashtëzakonshëm të papenguar në sistemin e video-mbikëqyrjes në pjesën e audio incizimit në lokalet e tij, që është kundërvajtje sipas nenit 110 paragrafi (1) pika 20 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nenit 110 paragrafi (2), ndërsa në lidhje me nenin 110 paragrafi (1) pika 20 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4.4.5 Procedura për kundërvajtje

Në vitin 2023 në Komisionin për vendimmarrje sipas kundërvajtjes në Agjenci („Komisioni për kundërvajtje”) janë dorëzuar 6 kërkesa për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

Në lidhje me këto kërkesa nga ana e Komisionit për kundërvajtje janë miratuar 6 aktvendime me të cilat është shqiptuar sanksion kundërvajtës – gjobë për personin juridik dhe personin përgjegjës te personi juridik, përkatësisht:

- për kryerjen e kundërvajtjes në pajtim me nenin 110 paragrafi (1) pika 20 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht mos mundësimin e kryerjes pa pengesa të supervizionit të jashtëzakonshëm sipas dispozitave të nenit 106 të këtij ligji, gjobë e llogaritur nga gjithsej të hyrat vjetore të realizuara në vitin afarist, i cili i paraprin vitit kur është kryer vepra penale, për personin juridik në shumë prej 190.055,00 denarë dhe për personin përgjegjës te personi juridik 18.447,00 denarë;
- për kundërvajtje në pajtim me nenin 111 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 9 paragrafi (1) alinetë 1, 2 dhe 3 dhe nenit 10 të këtij ligji, ndërsa në lidhje me dispozitat nga neni 9 paragrafët (2) dhe (3) të Ligjit për letërnjoftim dhe dispozitat për veprimtari të hotelarisë, ka mbajtur letërnjoftimet e mysafirëve (subjekte të të dhënave personale) dhe pas regjistrimit të tyre në librin e të ftuarve deri në largimin e tyre, gjobë nga të ardhurat totale vjetore të realizuara në vitin afarist që i paraprin vitit kur është kryer kundërvajtja në shumë prej 380.110,00 denarë për personin juridik dhe 21.522,00 denarë për personin përgjegjës te personi juridik;
- për kundërvajtje në pajtim me nenin 111 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 paragrafi (1) alineja 1 të këtij ligji pa pëlqimin e dhënë më parë për përpunimin e të dhënave personale kanë përpunuar të dhënat personale dhe nuk kanë mundur të demonstrojnë (dëshmojnë) se subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin në kuptim të dispozitave të nenit 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjobë e matur nga të hyrat totale vjetore të realizuara në vitin afarist dhe para vitit kur është kryer kundërvajtja, për personin juridik në shumë prej 217.720,00 denarë dhe për personin përgjegjës te personi juridik 18.448,00 denarë;
- për vepër kundërvajtëse në pajtim me nenin 111 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 paragrafi (1) alineja 1 të këtij ligji pa pëlqimin e dhënë më parë për përpunimin e të dhënave personale kanë përpunuar të dhënat personale dhe nuk kanë mundur të demonstrojnë (dëshmojnë) se subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin në kuptim të dispozitave të nenit 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjobë e matur nga të hyrat totale vjetore të realizuara në vitin afarist që dhe para vitit kur është kryer kundërvajtja, për personin juridik në shumë prej 217.720,00 denarë dhe për personin përgjegjës te personin juridik 18.448,00 denarë;



- për vepër kundërvajtëse në pajtim me nenin 111 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 paragrafi (1) alineja 1 të këtij ligji pa pëlqimin e dhënë më parë për përpunimin e të dhënave personale kanë përpunuar të dhënave personale dhe nuk kanë mundur të demonstrojnë (dëshmojnë) se subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin në kuptim të dispozitave të nenit 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave Personale, gjobë e matur nga të hyrat totale vjetore të realizuara në vitin afarist që dhe para vitit kur është kryer vepra kundërvajtëse, për personin juridik në shumë prej 217.720,00 denarë dhe për personin përgjegjës te personi juridik 18.448,00 denarë;
- për kundërvajtje në pajtim me nenin 111 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 të këtij ligji, kanë përpunuar në mënyrë të kundërligjshme të dhëna personale dhe nuk kanë mundur t'i demonstrojnë (dëshmojnë) bazën ligjore për përpunimin e të dhënave personale, gjobë e matur nga totali i të ardhurave vjetore të realizuara në vitin afarist para vitit kur është kryer vepra kundërvajtëse në shumë prej 217.720,00 denarë për personin juridik dhe 18.453,00 denarë për personin përgjegjës. në personin juridik.

Kundër aktvendimeve të Komisionit për kundërvajtje gjatë vitit 2023 janë iniciuar 6 konteste administrative, për të cilat janë përgatitur gjashtë përgjigje në padi dhe janë dorëzuar në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga ana e Gjykatës Administrative janë pranuar 2 aktgjykime nga kontestet administrative të iniciuara në vitin 2023, nga të cilët një konfirmon vendimin e Komisionit për kundërvajtje, gjegjësisht padia është refuzuar si e pabazuar dhe një aktgjykim me të cilin padia është lënë në fuqi dhe lënda kthehet në rigjykim dhe vendimmarrje në Komisionin për kundërvajtje. Komisioni për kundërvajtje, pas rishqyrtimit të tërë dokumentacionit të lëndës dhe duke marrë parasysh udhëzimet e Gjykatës Administrative lidhur me procedurat e zgjidhjes sipas dispozitave të Ligjit për kundërvajtje, ka sjellë aktvendim të ri me të cilin shqipton sanksion për kundërvajtje - gjobë për kundërvajtje të kryer në pajtim me nenin 110 paragrafi (1) pika 20 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht mos mundësimin e kryerjes pa pengesa të supervizionit të jashtëzakonshëm sipas dispozitave të nenit 106 të këtij ligji, gjobë e llogaritur nga të hyrat totale vjetore të realizuara në vitin afarist që i paraprin vitit kur është kryer vepra kundërvajtëse për personin juridik në shumë prej 190.055,00 denarë dhe për personin përgjegjës te personin juridik 18.448,00 denarë.

Në lidhje me procedurën kundërvajtëse të iniciuar me kërkesë në vitit 2021, me të cilën Komisioni për kundërvajtje ka marrë aktvendim me të cilin është shqiptuar sanksion kundërvajtës – gjobë për kundërvajtje në pajtim me nenin 110 paragrafi (1) pika 20 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale për personin juridik dhe personin përgjegjës te personi juridik, nga Gjykata e Lartë Administrative e Republikës së Maqedonisë së Veriut është pranuar aktgjykim, me të cilin ankesa refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Administrative është vërtetuar (refuzohet padia si e pabazuar), me çka vërtetohet edhe vendimi i Komisionit për Kundërvajtje.

4.4.6 Konteste administrative

Gjatë vitit 2023, Kundër aktvendimeve të Agjencisë janë iniciuar gjashtë (6) konteste administrative. Për tre (3) raste janë marrë aktgjykime me të cilat vërtetohen aktvendimet e Agjencisë, ndërsa për një (1) rast është marrë aktgjykim me të cilin shfuqizohet aktvendimi i Agjencisë dhe për të njëjtën Agjencia ka përgatitur aktvendim të ri sipas udhëzimeve të Gjykatës Administrative

Për katër (4) kontestet administrative të iniciuara në vitin 2022, në vitin 2023 janë pranuar katër (4) aktvendime nga Gjykata Administrative. Me dy (2) aktgjykime vërtetohen vendimet e Agjencisë, me një (1) aktgjykim aktvendimi i Agjencisë shfuqizohet dhe për të njëjtin Agjencia



ka përgatitur aktvendim të ri sipas udhëzimeve të Gjykatës Administrative dhe me një (1) aktvendim ndërpritet kontesti administrativ për shkak të vdekjes së paditësit.

Gjatë vitit 2023 janë paraqitur katër (4) ankesa kundër aktgjykimeve të Gjykatës Administrative për kontestet administrative të iniciuara në vitin 2021, 2022 dhe 2023. Gjykata e Lartë Administrative ka shfuqizuar aktvendimin e Gjykatës Administrative të vitit 2023 për shkak se nuk i është dorëzuar e gjithë lënda për të vepruar dhe është kthyer në Gjykatën Administrative për rivendim. Gjykata Administrative ka përsëritur procedurën dhe ka nxjerrë aktgjykim me të cilin vërtetohet aktvendimi i Agjencisë.

4.4.7 Kërkesa të tjera nga persona fizik

Në vitin 2023, Sektori i supervizionit ka vepruar në 21 kërkesa të personave fizik, të cilëve u janë dhënë udhëzime se ku dhe si të ushtrojnë njërën nga të drejtat e përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht të drejtën për kundërshtim.

4.4.8 Cenimi i sigurisë së të dhënave personale

Në bazë të nenit 37 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, në rast të cenimit të sigurisë së të dhënave personale, kontrolluesi është i detyruar të njoftojë Agjencinë menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë pasi ka mësuar për të njëjtën, për cenimin e sigurisë së të dhënave personale, përveç nëse nuk ekziston mundësia që cenimi i sigurisë së të dhënave personale të krijojë rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizik.

Gjatë vitit 2023, në Agjenci janë dorëzuar 20 njoftime për cenim të sigurisë së të dhënave personale, nga të cilat: 16 nga kontrolluesit t e sektorit privat dhe 4 (katër) nga kontrolluesit e sektorit publik. Nga numri i njoftimeve të dorëzuara, mund të konstatohet se kontrolluesit ende nuk janë në dijeni të detyrimit për të paraqitur njoftim për cenim të sigurisë së të dhënave personale.

Duke vepruar në rastet në të cilat është konstatuar ose ka dijeni për cenim të mundshme të sigurisë së të dhënave personale, në të gjitha rastet është konstatuar se kontrolluesit nuk kanë krijuar sistem të plotë për dokumentimin dhe raportimin e cenimeve të sigurisë së të dhënave personale, të cilat përfshijnë gjithashtu vlerësim të duhur të probabilitetit të rrezikut për të drejtat dhe liritë e personave fizikë në rast të cenimit.

Duke marrë parasysh situatën e krijuar në këto raste, mund të konkludohet se kontrolluesit, përveçse nuk kanë sistem plotësisht të krijuar për dokumentimin dhe raportimin e cenimeve të sigurisë së të dhënave personale, në përgjithësi nuk bëjnë dallimin midis incidentit dhe cenimit, ndryshimi midis rrezikut të mundshëm për kontrolluesin dhe rrezik i mundshëm për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave personale, si dhe kanë frikë të paraqesin njoftim në Agjenci për cenimin e sigurisë së të dhënave personale edhe pse paraqet detyrim ligjor.

Agjencia ka kryer dy supervizione të jashtëzakonshme pas katër (4) njoftimeve nga viti 2023, në tre kontrollues nga sektori publik dhe një kontrollues nga sektori privat. Në një rast, përveç kontrolluesit nga sektori publik, lëndë e supervizionit ka qenë edhe përpunuesi (shoqatë e qytetarëve).

4.4.9 Programi vjetor i supervizionit për vitin 2024

Gjatë përgatitjes së Programit vjetor të supervizionit për vitin 2024, para së gjithash janë marrë parasysh: fushat për të cilat ka pasur numër më të madh të kërkesave të paraqitura për konstatimin e shkeljeve të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale për vitin 2023, parashtrirat e dorëzuara në vitin 2023, njoftimet për cenimet e sigurisë së të dhënave personale, si dhe detyrimet e marra nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Udhërrëfyesin për sundimin e ligjit, i cili mbulon këto fusha: shëndetësi, financa, organet e pushtetit qendror shtetërore



(organet shtetërore, organet e administratës shtetërore , agjencitë dhe organet e tjera), mbrojtja sociale, marrëdhëniet e punës dhe tregtia.

Pasqyrë e supervizioneve është dhënë në pjesën Shtojcat, si *shtojca nr. 9, 10, 11 dhe 12.*

4.5 Harmonizimi i rregullores sektoriale

Ligjet dhe dispozitat tjera që rregullojnë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, përdorimin dhe dorëzimin e të dhënave personale duhet detyrimisht të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për këtë qëllim, Agjencia ka miratuar Vendim për përcaktimin e Metodologjisë për harmonizimin e legjislacionit sektorial („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 38/22). Metodologjia për harmonizimin e legjislacionit sektorial përmban udhëzime për zbatimin praktik të nenit 10 paragrafi (3) të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto udhëzime rregullojnë veprimet e ministrive në proceset për harmonizimin e legjislacionit sektorial, i cili përfshin procesin e kontrollit të ligjeve ekzistuese si dhe procesin e zbatimit të Vlerësimit të ndikimit të ligjeve nga aspekti i mbrojtjes së të dhënave personale, të cilat janë harmonizuar me përvojat pozitive nga praktika në Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare të tij si dhe legjislacionin e tij.

Në të njëjtën kohë, fokusi kryesor i Agjencisë për zbatimin e dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale, përkatësisht njëra nga aktivitetet primare sipas Programit të punës së Agjencisë për vitin 2023 është promovimi i Metodologjisë për harmonizimin e legjislacionit sektorial në lidhje me përgatitjen e vlerësimit të ndikimit të ligjeve nga aspekti i mbrojtjes së të dhënave personale nga propozuesit (ministritë) gjatë hartimit të propozim ligjeve me të cilat rregullohet mbledhja, përpunimi, ruajtja, përdorimi dhe dorëzimi i të dhënave personale. Në këtë kontekst, Agjencia u dha ministrive udhëzime se në çfarë mënyre dhe si duhet kryer vlerësimi, gjegjësisht si t'i qasen zbatimit të tij në mënyrë që të mund të mbulohen dhe shtjellohen çështjet që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale, dhe më pas në bazë të vlerësimit të kryer mund të konceptohen në zgjidhjet normative në ligjet përkatëse.

Gjithashtu, në mënyrë që Agjencia të zbatojë plotësisht kompetencat e saja, veçanërisht në lidhje me dhënien e mendimeve për propozimet e dispozitave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, është e nevojshme të zbatohen plotësisht dispozitat e nenit 68 paragrafi 1 pika 12 dhe paragrafi (3) nga Rregullorja e punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht të mos shqyrtohen në seancë të trupave punues dhe të Qeverisë materialet që rregullojnë çështje nga sfera e mbrojtjes së të dhënave personale pa mendim paraprak të dhënë nga Agjencia, me qëllim të sigurimit të konsistencës në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në aspekt të zbatimit konsequent, gjegjësisht harmonizimin me parimet dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale të parapara me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

4.5.1 Mendime, konsultime, sugjerime organeve të pushtetit qendror dhe organeve shtetërore

Agjencia, në kuadër të kompetencave të saja të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, me iniciativë të sajë ose sipas kërkesës jep mendime Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe institucioneve dhe organeve të tjera për masat legjislative dhe administrative për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, përkatësisht jep mendime për propozimet e dispozitave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Gjatë vitit 2023 janë dhënë 11 mendime për propozim ligje, akte nënligjore dhe materiale të tjera në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, që kanë të bëjnë në çfarëdo mënyre me mbrojtjen e të dhënave personale.

Pasqyrë të mendimeve të dhëna për propozim-ligje, akte nënligjore dhe materiale të tjera janë dhënë në pjesën Shtojcat, si *Shtojca nr. 13.*



Organet e pushtetit qendror mund të konsultohen me Agjencinë edhe gjatë hartimit të propozim ligjeve ose akteve nënligjore që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

Prandaj, nga ana e Agjencisë janë dhënë 7 konsultime (udhëzime) për propozim-ligje, akte nënligjore dhe materiale të tjera me qëllim që organet shtetërore të zbatojnë më lehtë parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sipas dispozitave të parashikuara në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pasqyrë të propozim ligjeve, akteve nënligjore dhe materialeve të tjera të cilat i janë dorëzuar Agjencisë për konsultim paraprak janë dhënë në pjesën Shtojcat, *si Shtojca nr.14*.

Duke marrë parasysh nevojën e harmonizimit të dispozitave me të cilat rregullohet mbledhja, përpunimi, ruajtja, përdorimi dhe dorëzimi i të dhënave personale me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa praktikë më e zakonshme është se organet shtetërore, çështjet që kanë të bëjnë me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale që duhet të përcaktohen me ligj, t'i përcaktojnë me akte nënligjore dhe dispozita të tjera, gjatë vitit 2023 Agjencia ka dërguar 13 sugjerime organeve shtetërore në lidhje me dispozitat dhe instrumentet e tjera ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pasqyrë e sugjerimeve të dhëna organeve shtetërore në lidhje me dispozitat dhe instrumentet e tjera ligjore janë dhënë në pjesën Shtojcat, *si Shtojca nr. 15*.

Mbetet edhe më tej detyrimi dhe nevoja që ministritë të identifikojnë ligjet ekzistuese relevante që duhet të ndryshohen (ndryshohen dhe plotësohen) që të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht të kontrollohen ligjet ekzistuese nga aspekti i përpunimit të të dhënave personale sipas Metodologjisë për harmonizimin e legjislacionit sektorial

4.5.2 Njoftime, udhëzime, përgjigje, sugjerime dhe urdhëresa të dhëna kontrolluesve, përpunuesve

Një pjesë e detyrave të Agjencisë është të ndjekë dhe realizojë zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të promovojë ndërgjegjësimin e publikut dhe kuptimin për rreziqet, rregullat, masat mbrojtëse dhe të drejtat në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, kontrolluesve, përpunuesve u janë dhënë udhëzime, njoftime, përgjigje, sugjerime , paralajmërime, urdhëresa edhe atë:

- janë dhënë 245 udhëzime/njoftime/përgjigje për përgatitje, përkatësisht në aspektin e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale (mënyra e përgatitjes, në cilat raste është e detyrueshme dhe çfarë duhet të përmbajë metodologjia për zbatimin e procesit të këtij vlerësimi); në cilat raste duhet dhe në cilat raste nuk duhet të caktohet zyrtar (oficer) për mbrojtjen e të dhënave personale, gjegjësisht si të bëhet analizë për të vlerësuar nëse duhet të caktohet zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale; në çfarë mënyre dhe si duhet të bëhet analizë gjatë angazhimit të përpunuesve; si duhet të rregullohet raporti ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit; rregullimi i mënyrës së shkëmbimit të të dhënave personale; çfarë duhet të merret parasysh dhe të ndërmerret përpara fillimit të përdorimit të një zgjidhjeje të re teknologjike përmes së cilës do të kryhet përpunimi i të dhënave personale; dhënia e të dhënave për shfrytëzim; përpunimi i të dhënave personale në bazë të pëlqimit, apo çfarë duhet të merret parasysh kur pëlqimi përdoret si bazë për përpunim dhe në çfarë mënyre e njëjta duhet të konceptohet; mënyrën e informimit paraprak të subjekteve të të dhënave personale, përkatësisht sigurimin e informacioneve transparente në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale; për përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale; veçanërisht të dhënat biometrike; për mënyrën e kryerjes së kontrollit të brendshëm të sistemit të informacionit dhe infrastrukturës së informacionit për të kontrolluar nëse procedurat dhe udhëzimet e përfshira në rregullat dhe politikat për sigurinë e të dhënave personale zbatohen dhe janë në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale; si



subjektet e të dhënave personale mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale.

- **2** sugjerime që i rreferohen rregullave të publikuara për lojë shpërblyese ku ishte e nevojshme korigjimi i tyre në lidhje me kategoritë e të dhënave personale që janë të nevojshme dhe në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe rregullimit të mënyrës së dhënies së informacionit të mëparshëm në lidhje me përpunimin që i referohet subjektit të të dhënave personale në mënyrë koncize, transparente, të kuptueshme dhe në një formë lehtësisht të aksesueshme, duke përdorur një gjuhë të qartë të thjeshtë, si dhe në lidhje me deklaratën/pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale nga punonjësit.
- **1** paralajmërim i cili referohet gjatë përmirësimit të sistemit për të kryer vlerësimin e ndikimit të operacioneve të planifikuara të përpunimit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e nenit 39 paragrafi (1) të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë që të zvogëlohet (minimizohet) probabiliteti që operacionet e planifikuara të përpunimit të të dhënave personale gjatë këtij procesi mund të shkelin dispozitat e këtij ligji dhe të njëjtat duhet të dokumentohen në mënyrë që të mund të demonstron pajtueshmëria me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale (llogaridhënie) sipas nenit 9 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- **4** urdhëresa për kontrolluesit, përkatësisht: 3 urdhëresave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, gjegjësisht fshirjen e të dhënave personale të subjektit të të dhënave personale dhe njoftimin e subjektit për veprimet dhe aktivitetet e ndërmarra dhe 1 urdhëresë për korigjimin e të dhënave të pasakta të subjektit të të dhënave personale.

Në bazë të urdhëresave të dhëna, kontrolluesit kanë vepruar dhe për veprimet e ndërmarra kanë dorëzuar njoftim me dëshmi në Agjenci.

4.5.3 Trajtim të parashtrësive

Numri i përgjithshëm i parashtrësive të dorëzuara në vitin 2023 është **258**

- **251** parashtrësia janë dorëzuar nga persona fizik;
- **7** parashtrësia janë dorëzuar nga persona juridik;
- **184** parashtrësia janë dorëzuar në mënyrë elektronike;
- **74** parashtrësia janë dorëzuar me shkrim.

Nga numri i përgjithshëm i parashtrësive **91%** janë për keqpërdorime në rrjetet sociale, **9%** për lloje të tjera të parashtrësive nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale

Pasqyrë për trajtim të parashtrësive dhe mënyra e dorëzimit të parashtrësive janë dhënë në pjesën Shtojcat, si *Shtojca nr. 16 dhe 17*.

4.5.4 Parashtrësit në lidhje me rrjetet sociale

Parashtrësit që kanë të bëjnë me rrjetet sociale për vitin 2023 gjithsej janë **234**.

Sipas arsyes së parashtrimit, më karakteristike janë parashtrësit nga persona fizik që kanë të bëjnë me profilet e rrejshme, më tej për profilet e hakuara, parashtrësit që kanë të bëjnë me publikimin e fotografive të të tjerëve, video dhe audio regjistrime në profilet e të tjerëve në rrjetet sociale, email adresat e keqpërdorura, zbulimi i autorit si dhe parashtrësia të cilat i referohen fyerjeve, shpifjeve dhe shantazheve në internet, **115** parashtrësia i referohen profileve të rrejshme, ndërsa **8** parashtrësia i referohen profileve të hakuara.

Nga numri i përgjithshëm i parashtrësive **10** prej tyre i referohen shkeljes së të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale të personave të mitur në rrjetet sociale.

Sipas rrjetit social të cilit i referohen parashtrësit, numri më i madh referohet Facebook, Instagram, TikTok si dhe një numër i caktuar i parashtrësive i referohen në Snapchat Onlyfans, Yahoo, Google etj.



Pasqyrë e parashtresave për rrjetet sociale janë dhënë në pjesën Shtojcat, *si shtojca nr. 18*.

4.5.5 Lëshimi i miratimeve për përpunimin e të dhënave personale

Gjatë vitit 2023 janë parashtruar 5 (pesë) kërkesa për miratim nga ana e Agjencisë në pajtim me nenin 84 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave biometrike, të nevojshme për konfirmimin e identitetit të subjektit të të dhënave personale ndërsa 1 për të dhënat që kanë të bëjnë me shëndetin e njerëzve.

Në lidhje me parashtrimin e kërkesave janë lëshuar Aktvendime adekuate, përkatësisht: 2 (dy) Aktvendime për miratimin e të dhënave biometrike të nevojshëm për konfirmimin e subjekteve të të dhënave personale, me çka për fillimin e përpunimit, kontrolluesit ishin të detyruar për marrjen dhe dokumentimin e veprimeve dhe aktiviteteve të caktuara në lidhje me sigurinë e përpunimit të të dhënave personale dhe 1 Aktvendim për refuzimin e kërkesës për përpunimin e të dhënave biometrike sepse nga ana e parashtruesve të kërkesave në Vlerësimin e ndikimit për mbrojtjen e të dhënave personale nuk ishte vlerësuar domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i operacioneve të përpunimit në lidhje me qëllimet në të cilin vlerësim duhet të përfshihen si kriter masa të caktuara të parashikuara për harmonizim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale gjegjësisht masat që kontribuojnë në domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit bazuar në: qëllime të qarta konkrete dhe legjitime; ligjshmërinë e përpunimit; të dhëna personale të përshtatshme dhe relevante dhe të kufizuara në atë që është e nevojshme dhe afat të kufizuar të ruajtjes.

Në lidhje me 2 (dy) kërkesa, procedura për miratim ka vazhduar në vitin 2024.

Në lidhje me kërkesën e parashtruar në vitin 2022, ndërsa procedura ka vazhduar në vitin 2023, është marrë vendim për refuzimin e kërkesës, për shkak se Parashtruesi nuk ka paraqitur në Vlerësim ligjshmërinë e përpunimit për qëllimin, si dhe mënyrën të sigurimit të pëlqimit nga subjekti i të dhënave personale sipas kushteve të pëlqimit të përcaktuara në dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

4.6 Qasje e lirë deri te informatat me karakter publik

Gjatë vitit 2023, në Agjenci janë dorëzuar gjithsej 5 (pesë) kërkesa për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik, kështu që në 4 (katër) kërkesa është përgjigjur pozitivisht ndërsa 1 (një) kërkesë është refuzuar me arsyetimin se nuk është informacion publik. Kundër aktvendimeve të Agjencisë janë parashtruar 3 (tre) ankesa në Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione Publike, njëra prej të cilave ishte e vitit paraprak 2022, 2 (dy) ankesa janë miratuar me vendim të Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione të Karakterit Publik dhe Agjencia ka vepruar sipas vendimeve dhe ka mundësuar qasje në informata. 1 (një) ankesë kundër Agjencisë është refuzuar nga Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione Publike si e papranueshme.

Në përgjithësi, këto kërkesa janë të lidhura me dorëzimin e kopjeve të dokumentacionit nga lëndët e supervizionit/mbikëqyrjes, kërkesë për numrin e parashtresave, trajnimeve, supervizioneve të kryera dhe aktiviteteve të Agjencisë në vitin 2023, etj.

4.7 Marrëdhëniet me Publikun

Agjencia e informon publikun përmes kanaleve të veta digjitale për të gjitha informatat relevante për punën e saj, përmes faqes zyrtare www.azlp.mk dhe përmes profileve në rrjetet sociale Facebook (Facebook) dhe LinkedIn (LinkedIn). Faqja zyrtare e Agjencisë përditësohet rregullisht me përmbajtje të dobishme si lajme, risi, njoftime, këshilla, udhëzime, mendime, aktvendime dhe rekomandime përmes të cilave personat fizik, kontrolluesit, përpunuesit, zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale, etj. informohen në kohë për risit dhe aktivitetet e Agjencisë, si dhe për të gjitha risitë në fushën e të dhënave personale.



Në këtë kontekst, është dhënë pasqyrë e aktiviteteve të Agjencisë për vitin 2023, të organizuara për promovimin dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë dhe pjesëmarrjen e saj në ngjarje:

Me rastin e „Ditës Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, më 28 janar, përkatësisht „Dita e Privatësisë” me Delegacionin e Bashkimit Evropian, Fondacionin Metamorfozis dhe Qendrën për Kërkime dhe Analiza Ligjore përmes mbajtjes së Konferencës me temë „Së bashku për mbrojtjen e të dhënave personale” me të cilën u theksua rëndësia e mbrojtjes së të dhënave personale si njëra ndër të drejtat themelore të njeriut. Qëllimi i shënimit të kësaj dite ishte ngritja e vetëdijes publike për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, dhe për këtë Agjencia njëkohësisht organizoi Ditë të hapura për qytetarët, e cila u mbajt në hapësirat e „East Gate” në Shkup. Në këtë aktivitet qytetarëve iu shpërndanë materiale informuese për njohje më të mirë me të drejtat e tyre si subjekte të të dhënave personale.

Më 7 shkurt 2023, u shënua dita ndërkombëtare „Dita e internetit të sigurt”, me moton „Mendoni para se të klikoni” në Sheshin Maqedonia, Shkup. Në këtë aktivitet qytetarëve iu shpërndanë materiale informative se si të mbrohen nga mashtrimet më të shpeshta në internet, gjegjësisht nga vjedhjet dhe keqpërdorimet e të dhënave të tyre personale, si dhe iu dhanë përgjigje të gjitha pyetjeve të qytetarëve në lidhje me përdorimin e internetit nga aspekti i mbrojtjes së të dhënave personale.

Më 14 shkurt 2023 Agjencia mori pjesë në punëtori online me temë të inteligjencës artificiale (IA), të parashikuar në kuadër të projektit të BE-së: „Mbrojtja teknike dhe e integruar e të dhënave personale - ndërtimi i një ekosistemi digjital gjithëpërfshirës”, i realizuar nga shoqata e qytetarëve Konekt në partneritet me Fondacionin Metamorfozis.

Më 4 dhe 5 prill 2023, në organizim të OJQ-së Gazetarë për të drejtat e njeriut, dhe në kuadër të projektit „Pilot projekt për sistem paralajmërimi të hershëm për personat e zhdukur” u realizua trajnim dyditor për ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve institucional në të cilën ka marrë pjesë Agjencia si trajner për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ndarjen e tyre.

Më 20 prill 2023 Agjencia mori pjesë në info ditë TAEKS, të organizuar nga Sekretariati për Çështje Evropiane dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian. Qëllimi i eventit ishte ndarja e udhëzimeve dhe asistencë për institucionet, agjencitë dhe sektorët përkatës gjatë aplikimit për shfrytëzimin e instrumentit TAEKS.

Në periudhën prej 12-13 prill në Veles, Agjencia mori pjesë në punëtorinë me titull „Statusi HIV: Baza për trajtim të ndryshëm apo diskriminim të arsyetuar” organizuar nga Shoqata për mbështetjen e personave me HIV „Së bashku më të fortë”. Në punëtori, pjesëmarrësit diskutuan dhe proceduan rastet e diskriminimit dhe shkëljes së të drejtave të njeriut të personave që jetojnë me HIV, të regjistruar nga Të gjithë më të fortë, si dhe rastet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më 18 maj Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) organizoi tryezë të rrumbullakët me temë: „Të rinjtë dhe përdorimi i të dhënave të tyre personale në internet”, në kuadër të projektit të Qeverisë së Zvicrës „Përkrahja e reformave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut”, ku mori pjesë Agjencia si njëra ndër palët relevante të interesit.

Më 21 korrik Agjencia publikoi në faqen e saj dhe në rrjetet sociale informacion për realizimin e supervizionit të jashtëzakonshme në Drejtorinë e librave amë pas iniciativës së parashtruar nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Më 11 shtator Agjencia mori pjesë në debatin publik për draft-Strategjinë për transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, organizuar nga Zyra e Zëvendëskryeministrit përgjegjës për politika të qeverisjes së mirë dhe Fondacionit Metamorfozis.

Më 4 tetor Agjencia ishte pjesëmarrëse në debatin publik për draft-Strategjinë për transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, organizuar nga Zyra e



Zëvendëskryeministrit përgjegjës për politika të qeverisjes së mirë dhe Fondacioni Metamorfozis e cila u mbajt në Veles.

Më 19 tetor në Shkup, Agjencia ishte pjesë e konferencës finale „Mbrotjtja e privatësisë në epokën digjitale: në kërkim të zgjidhjeve të përbashkëta” në kuadër të projektit „Mbrotjtja teknike dhe e integruar e të dhënave personale – ndërtimi i një ekosistem digjital gjithëpërfshirës” i implementuar nga Fondacioni Metamorfozis dhe shoqata Konekt. Qëllimi i konferencës ishte bashkimi i përfaqësuesve të institucioneve, organizatave civile, bizneseve etj, për të ndarë me ta më shumë informacione rreth rëndësisë së privatësisë, mbrotjtjes së të dhënave personale dhe të gjitha të drejtave të njeriut në përgjithësi në epokën digjitale në të cilën jetojmë.

Më 25 tetor Agjencia mori pjesë në grupin ndër sektorial të punës për biznesin dhe të drejtat e njeriut organizuar nga shoqata Konekt në kuadër të projektit të BE-së „Mbrotjtja teknike dhe e integruar e të dhënave personale – ndërtimi i një ekosistemi gjithëpërfshirës”.

Më 29 nëntor me rastin e 30 nëntorit, „Ditës ndërkombëtare të sigurisë kompjuterike”, Agjencia së bashku me Fondacionin Metamorfozis promovuan zyrtarisht faqen edukative në fushën e mbrotjtjes së të dhënave personale. Promovimi u zhvillua online përmes platformës ZOOM, ku qytetarët e interesuar mësuan më shumë për këtë mjet edukativ dhe funksionalitetet që përmban.

Më 12 dhjetor 2023, Agjencia zhvilloi seancë informuese në Klubin e deputetëve të organizuar nga Akademia e Tatimeve. Në sesionin informativ, përfaqësuesit e Agjencisë i njoftuan të pranishmit me parimet e mbrotjtjes së të dhënave personale, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale dhe sigurinë e përpunimit të të dhënave personale.

Më 18 dhjetor Agjencia mori pjesë në konferencën finale të projektit „Pilot-projekti për një sistem paralajmërimi të hershëm për personat e zhdukur”, organizuar nga OJQ Gazetarët për të Drejtat e Njeriut.

4.7.1 Bashkëpunimi me media

Edhe në vitin 2023, Agjencia qëndroi transparente dhe e hapur për bashkëpunim me mediat elektronike dhe të shkruara, ndërsa iu përgjigj 27 kërkesave të gazetarëve për çështje që lidhen me mbrotjtjen e të dhënave personale. Numri më i madh i pyetjeve gazetareske ishin në lidhje me kreditë e shpejta, video mbikëqyrjen, shkeljen e të drejtës për mbrotjtjen e të dhënave personale në rrjetet sociale, pyetje për inteligjencën artificiale etj. Agjencia, gjithashtu iu përgjigj thirrjeve të televizioneve dhe platformave të internetit që të jetë mysafir në emisione dhe për të dhënë intervista:

Agjencia më 7 shkurt ka dhënë deklaratë në Agjencinë për Informim të Maqedonisë - AIM me temë për numrin dhe llojin e parashtresave të qytetarëve në Agjenci, informatat për supervizionet e kryera dhe cenimet e raportuara të sigurisë për të cilat kontrolluesit janë të obliguar të njoftojnë Agjencinë, nëse ka gjasa që shkelja të krijojë rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizikë.

Në muajin mars mediumi „A1on.mk” realizoi video-intervistë me Agjencinë për pjesëmarrjen e qytetarëve në lojëra shpërblyese false dhe vjedhjen e të dhënave të tyre personale. Në intervistë u trajtua edhe tema e dhënies së kredive të shpejta me të dhëna personale të vjedhura dhe pa pëlqimin e qytetarëve.

Gjatë vitit 2023, Agjencia vazhdoi bashkëpunimin e suksesshëm me Institutin për Studime të Komunikimit (ISK) dhe ueb platformën e tyre „Samoprashaj.mk”. Instituti së bashku me Agjencinë, regjistroi një sërë përgjigjesh për pyetjet e bëra personalisht nga qytetarët në lidhje me dispozitat për mbrotjtjen e të dhënave personale. Pyetjet lidhur me informacionin për keqpërdorimin e të dhënave personale gjatë procesit të marrjes së një kredie të shpejtë, përpunimin e të dhënave personale dhe informacione të qytetarëve, ndarjen e tyre nga ana e



kompanive financiare në lidhje me dhënien e kredive të shpejta etj. Përgjigjet janë postuar në faqen e tyre të internetit.

Më 29 nëntor, Agjencia në emisionin e mëngjesit „E dua Maqedoninë” në televizionin „Sitel” dha deklaratë me temë raportimet e qytetarëve për profile të rreme në rrjetet sociale.

4.7.2 Komunikimi me palët

Gjatë vitit 2023, Agjencia vazhdoi t'u ofrojë palëve informacione përmes telefonit, ndërsa arsyeja për këtë ishte interesimi i madh i pyetjeve të personave fizik dhe juridik lidhur me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, në ambientet e Agjencisë zhvillohen rregullisht konsultime me palët, përkatësisht me persona fizikë dhe me përfaqësues të personave juridikë. Temat për të cilat u shfaq interesimi më i madh kishin të bënin me: dispozitat ligjore për vendosjen e video mbikqyrjes, përpunimin e të dhënave personale në rrjetet sociale, përpunimin e të dhënave personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, kompetencat e Agjencisë dhe në cilat raste mund të drejtohen në Agjenci etj.

Informacionet e dhëna palëve përmes telefonit – 1.328.

Konsultimet e zhvilluara me palët në ambientet e Agjencisë - 154.

4.8 Njoftimi për përpunimin e të dhënave personale me rrezik të lartë

Gjatë vitit 2023 nga ana kontrolluesve janë dorëzuar gjithsej 15 njoftime /kërkesa në lidhje me Evidencën elektronike të përmbledhjeve të të dhënave personale me rrezik të lartë, të cilin e udhëheq Agjencia në pajtim me nenin 71 paragrafi (3) të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, përkatësisht:

- 9 – Letra konfirmuese për regjistrim në Evidencën e përmbledhjeve të të dhënave personale me rrezik të lartë;
- 2 – Kërkesa për fshirjen e kontrolluesve nga Evidenca e përmbledhjeve të të dhënave personale me rrezik të lartë;
- 4 – Kërkesa për të rivendosur parametrat e hyrjes në Evidencën e përmbledhjeve të të dhënave personale me rrezik të lartë.

4.9 Zyrtarët (Oficerët) për mbrojtjen e të dhënave personale

Gjatë vitit 2023 nga ana e kontrolluesve/përpunuesve janë parashtruar gjithsej 637 shkresa/kërkesa/njoftime për caktimin e zyrtarit (oficerit) për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim të evidentimit në Evidencën e zyrtarëve (oficerëve) për mbrojtjen e të dhënave personale të udhëhequr nga Agjencia në pajtim me nenin 68 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa e njëjta publikohet në ueb faqen www.azlp.mk.

Gjatë vitit 2023 në Evidencën e zyrtarëve (oficerëve) për mbrojtjen e të dhënave janë regjistruar gjithsej 350 zyrtarë, gjegjësisht për ndryshimin e zyrtarëve të regjistruar gjithsej 103 kërkesa të reja, ndërsa në lidhje me 57 njoftime, Agjencia ju dërgoi njoftime shtesë kontrolluesve/përpunuesve për detyrimin ligjor për të dorëzuar detajet e kontaktit për zyrtarët (oficerët) për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe ekzistimin e konfliktit të interesit kur menaxheri caktohet edhe si zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndërsa pjesa tjetër e shkresave/kërkesave i referohet: ndryshimit të oficerëve, detyrimit dhe kushteve për caktimin e zyrtarit (oficerit), gjegjësisht kërkesave për fshirje nga evidenca e zyrtarëve tashmë të regjistruar etj.

Pasqyrë e detajuar është dhënë në pjesën Shtojcat, si *Shtojca nr. 19*.

4.10 Trajnime të realizuara

Agjencia deri në dhjetor të vitit 2023 përmes platformës Zoom organizoi dhe realizoi 8 trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale dedikuar kontrolluesve dhe përpunuesve, si dhe 1



trajnim në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes, me gjithsej **196** pjesëmarrës përfaqësues të **77** kontrolluesve ose përpunuesve.

Duke marrë parasysh vlerësimet e pjesëmarrësve në trajnime nga pyetësorët e dorëzuar për vlerësim, si dhe interesimin e lartë të vazhdueshëm për të marrë pjesë në trajnime, mund të konstatohet se trajnimet për mbrojtjen e të dhënave personale të realizuara nga stafi trajnues i Agjencisë janë të vlerësuara me notë të lartë cilësore. Kjo kryesisht për faktin se trajnimet për mbrojtjen e të dhënave personale që realizohen nga Agjencia ligjërohen nga persona profesionistë në punën e tyre, me përvojë shumëvjeçare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, të cilët kanë të bëjnë drejtpërdrejt me temën e fushës së mbrojtjes së të dhënave personale.

Pasqyrë e trajnimeve të realizuara nga ana e Agjencisë është dhënë në pjesën Shtojcat si *Shtojca nr.20*.

4.11 Transferimi i të dhënave personale në vende të tjera

Gjatë vitit 2023 është vepruar ndaj gjithsej **40 fletëparaqitjeve** për transferimin e të dhënave personale, të cilat i referohen transferimit të të dhënave personale në vendet e Bashkimit Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane, dhe **7** kërkesa për transferimin e të dhënave personale në vendet e treta për të cilën është e nevojshme që Agjencia të japë miratim në përputhje me dispozitat e nenit 50 paragrafi 3 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Janë dhënë gjithsej **19 mendime** kontrolluesve për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me transferimin e të dhënave personale dhe harmonizimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Në lidhje me përmbledhjet e të dhënave personale që përpunohen ose transferohen, nga ana e kontrolluesve zakonisht u referohen të dhënave personale të të punësuarve, kandidatëve për punësim, bashkëpunëtorëve të jashtëm, klientëve, furnitorëve etj.

Qëllimet më të zakonshme për të cilat kryhet transferimi janë mbështetja e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore të kontrolluesve që janë pjesë e grupeve ndërkombëtare, mirëmbajtjen e sistemeve të informacionit, shërbimet cloud, monitorimi dhe vlerësimi efektiv i programeve dhe standardeve të cilësisë, përbushja e detyrimeve kontraktuale.

Janë mbajtur gjithsej **19 takime** koordinuese me përfaqësues nga kontrollues, gjatë të cilave janë diskutuar disa çështje që kanë të bëjnë veçanërisht me sqarimin e klauzoleve kontraktuale, marrjen e masave teknike dhe organizative gjatë transferimit të të dhënave personale dhe sigurimin e dokumentacionit që dëshmon se janë siguruar garanci të përshtatshme për mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale.

Paraqitja tabelore në seksionin Shtojcat, si *Shtojcat nr. 21, 22, 23 dhe 24*.



5. AKTIVITETET PËR PËRMIRËSIMIN E KUALITETIT TË PUNËS

Agjencia edhe më tej vazhdoi të ndërmerr masa për nxitjen dhe rritjen e përdorimit të shërbimeve për parashtrimin e kërkesave në mënyrë elektronike dhe dorëzimin e dokumenteve për qasje më të lehtë deri te shërbimet tona për kontrolluesit dhe personat fizik, si dhe përdorimin e teknologjive të reja për zbatimin e supervizioneve mbi mbrojtjen e dhënave personale, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Agjencia dhe gjatë vitit 2023 promovoi kulturën e mbrojtjes së të dhënave personale përmes uebfaqes së saj www.azlp.mk, e cila u përgadit me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Në faqen e internetit të disponueshme janë përmbajtje të reja që mundësojnë qasje më të lehtë në informacione, udhëzime dhe formularë dedikuar për personat fizik dhe kontrolluesit/përpunuesit. Në këtë kuptim, në faqen e internetit janë publikuar udhëzues dhe materiale informative të reja të dedikuar për personat fizik dhe kontrolluesit „Udhëzues për raportimin e cenimeve të sigurisë së të dhënave personale”, „Udhëzues për masat teknike dhe organizative”, „Siguria kibernetike: Këshilla praktike për qytetarët se si të mbrohen nga mashtrimet në internet” dhe „Si t'i mbronni të dhënat tuaja personale nga vjedhja dhe keqpërdorimi?”.

Kështu, në vitin 2023, numri më i madh i kërkesave të parashtruara për konstatimin e shkeljes së të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kryerjen e supervizioneve janë dorëzuar përmes ueb platformës së ueb-faqes sonë www.azlp.mk, ndërsa numri i përdoruesve është në rritje të vazhdueshme të ueb platformës speciale për shkëmbimin e informacioneve me kontrolluesit dhe qytetarët (e-parashtrimi).

Duke ndjekur praktikën e mirë të vitit të kaluar, Agjencia vazhdoi të kryejë supervizione në mënyrë elektronike duke përdorur mjete softuerike që praktikisht digjitalizuan në tërësi operacionet në këtë segment. Para se gjithash, u përdorën mjetet softuerike HCL AppScan dhe Website Evidence Collection pa mos përdorur metoda invazive janë gjeneruar raporte të cilat janë pjesë përbërëse të procesverbaleve të këtyre supervizioneve.



6. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TJERA DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

6.1 Bashkëpunimi me institucionet e tjera

- Më 8 shkurt 2023, Agjencia mbajti takim me Kabinetin e Qeverisë përgjegjëse për politikën për qeverisje të mirë, në temë argumente ligjore pozitive dhe negative lidhur me “Shpalljen publike të pronarëve realë të shoqërive që kanë lidhur kontrata për prokurim publik në sistemin elektronik të prokurimit elektronik (ESJN)”. Qëllimi i takimit ishte gjetja e zgjidhjes me përpjekje të përbashkëta që do të forcojë masat kundër korrupsionit në prokurimet publike dhe do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve, pa cenuar parimet bazë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtën e privatësisë.
- Agjencia vazhdoi bashkëpunimin me Fondacionin për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis, duke pohuar përkushtimin e saj për të dhënë kontribut të përbashkët në promovimin dhe avancimin e mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve. Më 10 shkurt 2023 nënshkruan Marrëveshje për transferimin e një ueb faqe interneti edukative që u zhvillua në kuadër të projektit të BE-së „Mbrojtja teknike dhe e integruar e të dhënave personale - ndërtimi i një ekosistemi digjital gjithëpërfshirës”. Kjo ueb faqe interneti do të përmbajë materiale të ndryshme edukative dhe informative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe do t'u ofrojë mundësi qytetarëve dhe kontrolluesve për të kontrolluar dhe përmirësuar njohuritë e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale. Pas përfundimit të projektit të BE-së, Agjencia do të marrë përsipër ueb faqen e internetit <https://e-ucilnica.azlp.mk/> dhe do ta përdorë atë si platformë për trajnime elektronike për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Më 2 mars, Agjencia mori pjesë në takim koordinues me përfaqësues të Qeverisë përgjegjëse për politikën e qeverisjes së mirë, Këshillin Inspektues, Inspektoratin Shtetëror të Tregut dhe Inspektoratin Ligjor Shtetëror. Në takim u diskutua për nevojën për transparencë më të madhe në funksionimin e shërbimeve të inspektimit, me fokus të veçantë idenë e publikimit të akteve të inspektimit në ueb faqet e internetit të inspektorateve, duke zbatuar plotësisht rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Më 19 korrik, Agjencia ka mbajtur takim me Zëvendëskryeminstren për politikën e qeverisjes së mirë. Në takim u shqyrtua draft versioni i Ligjit për lëndën arkivore, nga pikëpamja e përafrimit të tij me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht në pjesën e prezantimit të Sistemit unik informativ arkivor dhe mbrojtjen e personave fizikë, të cilët janë mbajtës të materialit dokumentar publik.
- Më 31 gusht, Agjencia ka mbajtur takim me kryetaren e Këshillit inspektues. Në takim u diskutua për harmonizimin e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të udhëhequr nga nevoja e bashkëpunimit të ndërsjellët me institucionet e tjera për të zbatuar në mënyrë efektive kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj dhe duke konfirmuar angazhimin dhe interesin e përbashkët për të nxitur bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të të dyja palëve, Agjencia gjatë vitit 2023 nënshkroi 2 memorandume me institucione dhe organizata joqeveritare. Në muajin mars është nënshkruar memorandumimi me Ministrinë e Transportit dhe Lidhjes lidhur me realizimin e trajnimeve për mbrojtjen e të dhënave personale me qëllim zbatimin e plotë dhe korrekt të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale. Po ashtu, Agjencia së bashku me Qendrën për Hulumtime dhe Analiza Juridike, Asociacionin Maqedonas të Juristëve të Rinj dhe Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publik, nënshkruan memorandum bashkëpunimi për realizimin me sukses të projektit „Drejtësia efikase për mbrojtjen e elementeve themelore liritë dhe e drejta e privatësisë në hapësirën online”, mbështetur financiarisht nga BE. Projekti synon të forcojë kapacitetet e gjyqësorit dhe të prokurorisë publike për mbrojtjen efektive të privatësisë së qytetarëve, si dhe të drejtave dhe lirive të tjera themelore që preken nga teknologjitë e reja në hapësirën online në përputhje me ligjin dhe standardet e BE-së.



6.2 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Bashkëpunimi me autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale nga rajoni

Në frymën e rritjes së cilësisë dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet organeve mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale të Maqedonisë së Veriut, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Serbisë, Sllovenisë dhe Kosovës si shtete të ish-Jugosllavisë, u krijua “Iniciativa 20i7”.

Në periudhën prej 12-14 qershor në Pejë të Kosovës, Agjencia me përfaqësuesit e saj ka marrë pjesë në Takimin e Pestë të “Iniciativës 20i7” të organizuar nga Agjencia Kosovare për Informim dhe Privatësi, ku janë diskutuar çështjet aktuale të mbrojtjes së të dhënave personale. Autoritetet ndanë përvojën dhe pikëpamjet e tyre për tema të tilla si video mbikëqyrja, harmonizimi i legjislacionit sektorial me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, njoftimet për cenimet e sigurisë së të dhënave personale, vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale, oficerët e mbrojtjes së të dhënave personale, transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, certifikimi dhe ndanë përvoja rreth presioneve të kërcënimeve të të drejtave dhe lirisë themelore të qytetarëve gjatë pandemisë COVID.

Agjencia vazhdoi me sukses bashkëpunimin me Agjencinë Kroate për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AZOP), e cila në vitin 2023 organizoi dy punëtori online për të punësuarit e Agjencisë. Punëtoritë u mbajtën me temë: „Metodologjia e kryerjes së supervizionit” dhe „Vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Në periudhën 4-6 dhjetor 2023, në Shkup, Agjencia mori pjesë në Punëtorinë Rajonale për harmonizim me Rregulloren e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale (GDPR) në Ballkanin Perëndimor, organizuar nga GIZ (Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar). Në punëtorinë dy ditore morën pjesë autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale nga gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Serbia, Kosova, Mali i Zi dhe Bosnja-Hercegovina dhe ekspertë nga Kroacia ku ndanë përvojat dhe praktikën më të mirë për t'i ndihmuar ata drejt integritetit të tyre në BE. Përfaqësuesit nga autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale diskutuan zbatimin e Rregullores së përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale përmes shembujve nga praktika dhe dhanë një pasqyrë të sfidave dhe përparësive të harmonizimit me Rregulloren. Gjithashtu u diskutua për transferimin e të dhënave personale, mbrojtjen e kategorive të veçanta të të dhënave personale, si dhe masat që duhen ndërmarrë për të reduktuar rrezikun e cenimit të sigurisë së të dhënave personale.

Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës

Si çdo vit, Agjencia mori pjesë në seancën e 45-të plenare të Komitetit Konsultativ të Konventës 108 (T-PD), 15-17 nëntor 2023, Strasburg, Francë, organizuar nga Këshilli i Evropës. Temat kryesore ishin miratimi i modulit të dytë të klauzolave kontraktuale model për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi te përpunuesi dhe u diskutua për hartimin e udhëzimeve për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale për qëllime të regjistrimit dhe vërtetimit të votuesve. Gjithashtu u vendos që T-PD të fillojë punën për mbrojtjen e të dhënave në kuadrin e neuroshkencave si tema të radhës që do të trajtohet në kuadër të programit të saj të punës 2022-2025.

6.3 Pjesëmarrja e Agjencisë në ngjarje ndërkombëtare, konferenca që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale

- Agjencia ka statusin e vëzhguesit të punës së Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (EDPB), i cili është organ i pavarur për bashkëpunim ndërmjet organeve mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale që miraton mendime, udhëzime, rekomandime. për zbatimin e unifikuar të Rregullores së re të përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale të BE-së dhe krijimi i praktikave më të mira për zbatimin e saj. Prandaj, monitorimi i punës së



këtij organi është jashtëzakonisht i rëndësishëm për Agjencinë, prandaj më 14 dhe 15 shkurt 2023, Agjencia mori pjesë në seancën e 75-të plenare të Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë seancë u diskutua mbledhja e informacioneve në lidhje me hetimet ndërkuftare në shkallë të gjerë, procedura e miratimit të mendimeve të EOMDHP-së në lidhje me kriteret kombëtare të certifikimit dhe vultat evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale etj.

- Në shkurt të vitit 2023, delegacioni i Mbretërisë së Bashkuar dhe përfaqësues të Agjencisë diskutuan zbatimin e dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale nga ana e institucioneve shtetërore që kanë kompetenca në mbajtjen e evidencës penale, me theks të veçantë të Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me zbatimin e Ligjit për policinë në fushën e përpunimit të të dhënave personale. Temë e takimit të punës ishte Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë të Madhe dhe Irlandës së Veriut në lidhje me ndarjen e informatave për dosjet kriminale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në aspektin e mbrojtjes së të dhënave personale.

- Agjencisë mori pjesë në Konferencën e 31-të Pranverore të autoriteteve mbikëqyrëse Evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale, e cila u mbajt në Budapest, Hungari nga 10 deri më 12 maj 2023, organizuar nga Autoriteti Kombëtar Hungarez për mbrojtjen e të dhënave personale dhe liria e informacionit. Në Konferencë u debatua për numër të madh çështjesh aktuale: ndikimin e teknologjive të reja në të drejtat e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ndërveprimin midis ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjit për konkurrencën, u shqyrtua çështja e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet organeve për mbrojtjen e të dhënave personale nga EEO dhe vende të tjera, etj.

- Konferenca vjetore e të drejtave digjitale të BIRN Rrjetit Ballkanik të gazetarisë hulumtuese u zhvillua nga 5 deri më 6 dhjetor 2023, në Sarajevë. Agjencia së bashku me ekspertë të ndryshëm nga rajoni diskutuan sfidat e të drejtave digjitale në botën tonë gjithnjë e më të lidhur, duke u fokusuar në Ballkanin dhe Evropën Juglindore.


6.4 Projektet dhe ndihma e huaj

- Nga data 16 tetor 2023, Agjencia filloi përgatitjen e draft Strategjisë për mbrojtjen e të Dhënave Personale 2024-2030. Për përgatitjen e propozim Strategjisë, Agjencia ka siguruar ndihmë të ekspertëve nga Komisioni Evropian me instrumentin TAEX, përmes të cilit është planifikuar të organizohen një sërë ngjarjesh që do të na mundësojnë të vendosim një vizion të ri për evoluimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, praktikë dhe kulturë për mbrojtjen e të dhënave personale. Strategjia është një dokument kyç për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe paraqet instrument që do të përshkruajë gjendjen e sistemit për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe do të sigurojë qasje të plotë dhe të modernizuar në mbrojtjen e kësaj të drejte të njeriut. Nga ana e Agjencisë u kërkuan 5 ngjarje që përfshijnë asistencën e ekspertëve, seminare dhe një konferencë përfundimtare që filluan në fund të vitit 2023 dhe do të vazhdojë edhe në vitin 2024.

Ngjarja e parë u organizua në periudhën nga 16 deri më 20 tetor 2023, në të cilën ekspertë nga Sllovenia dhe Finlanda së bashku me Agjencinë zhvilluan konsultime me përfaqësues nga sektori publik dhe privat, si dhe shoqata të qytetarëve. Në këtë ngjarje, palët e interesuara dhanë kontributin e tyre në zhvillimin e propozim strategjisë dhe si rezultat, ekspertët do të ndihmojnë dhe këshillojnë Agjencinë në përgatitjen e strategjisë së re. Agjencia më tej publikoi thirrje publike në faqen e saj të internetit për të gjitha palët e interesuara, përkatësisht përfaqësuesit e kontrolluesve nga sektori publik dhe privat, përpunuesit, organizatat joqeveritare, hartuesit e ligjeve dhe qytetarët që të angazhohen aktivisht në këtë proces.



- Në kuadër të projektit „*Drejtësia efikase për mbrojtjen e lirive themelore dhe të drejtën e privatësisë në hapësirën online*” të mbështetur financiarisht nga BE-ja, Qendra për Kërkime dhe Analiza Ligjore (CPIA), Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj nënshkruan memorandum bashkëpunimi për realizimin e suksesshëm të projektit. Memorandumi parashikon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve në interes të arritjes së qëllimeve të projektit, i cili do të realizohet përmes shkëmbimit të informacioneve, pjesëmarrjes në nismat e projektit dhe mbështetjes gjatë realizimit të aktiviteteve të projektit. Për këtë qëllim, CPIA në bashkëpunim me Agjencinë nga data 31 tetor deri më 2 nëntor 2023 ka marrë pjesë në misionin e ekspertëve të TAEKS (TAEIX) për përgatitjen e „*Udhëzuesit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtës së privatësisë në hapësirën digjitale për përdorim praktik nga gjyqtarë, prokurorë publikë dhe avokatë në përputhje me praktikën dhe standardet e BE-së për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë*”.





7. PUNA FINANCIARE

7.1 Realizimi i buxhetit për vitin 2023 – LLOGARIA lloji 637

Buxheti i Agjencisë (me ribalancim dhe rialokime të miratuara) për vitin 2023 në llogarinë 637 arrin në 17.305.000,00 denarë .

Nga buxheti i përgjithshëm i Agjencisë për vitin 2023 në shumën 17.305.000,00 denarë janë realizuar 94.03% gjegjësisht 16.271.543,00 denarë. Sa i përket realizimit të Buxhetit me të gjitha rialokimet e miratuara të mjeteve gjatë vitit 2023 12.846.770,00 denarë ose 78.95 % e mjeteve i referohen realizimit të pagave dhe kompensimeve, 3.214.745,00 denarë ose 19.76 % e mjeteve kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime, 93.252,00 denarë ose 0,57 % i referohen zërit transfere të ndryshme 48.354,00 denarë për blerje pajisje dhe makineri ose 0,30% dhe 68.422,00 denarë për investime dhe mjete jo financiare ose 0,42 %.

Sipas pasqyrës së realizimit të burimeve financiare për vitin 2023 krahasuar me buxhetin e miratuar për vitin 2023, është e dukshme se niveli i realizimit të buxhetit të përgjithshëm është 94.03%, që paraqet një përqindje të lartë të realizimit të të njëjtit, si dhe planifikimi real i buxhetit për vitin 2023.

Nga të dhënat e paraqitura qartë shihet se buxheti i miratuar i Agjencisë për vitin 2023 është për 315.000,00 denarë më i lartë në krahasim me vitin 2022, që është për shkak të rritjes së pagave në mars 2023 në bazë të rritjes së pagës minimale, si dhe rritje 10% në shtator 2023 në përputhje me Marrëveshjen kolektive për të punësuarit në sektorin publik.

7.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2023 – LLOGARIA lloji 631

Buxheti i Agjencisë për vitin 2023 në llogarinë 631 është planifikuar të jetë 3.500.000,00 denarë.

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bazë të realizimit të trajnimeve për mbrojtjen e të dhënave personale për kontrolluesit dhe përpunuesit e interesuar të të dhënave personale gjatë vitit 2023 ka realizuar të hyra prej 1.003.000,00 denarë.

Nga buxheti i përgjithshëm i miratuar i të hyrave të parashikuara të Agjencisë për vitin 2023 në vlerë prej 3.500.000,00 denarë janë realizuar 2,68% ose 93.932,00 denarë.

Sa i përket strukturës së mjeteve të realizuara, 69,75% e mjeteve i referohen zërit mallra dhe shërbime (materiale dhe inventar i imët, riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme për nevojat e Agjencisë), dhe 30,25% për blerje pajisjesh dhe makinerish.

Pasqyrat e buxhetit dhe punës financiare janë dhënë në pjesën Shtojcat, si *Shtojca nr. 25, 26, 27, 27-a, 28, 28-a, 29, 30, 31 dhe 32.*



8. KONKLUZIONE

Raporti vjetor jep pasqyrë të aktiviteteve të realizuara me zbatimin e dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale në praktikë, pasqyrim të supervizioneve të kryera në përputhje me kompetencat ligjore, perceptimin e gjendjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe mendimet dhe sugjerimet e dhëna.

Sfidë për Agjencinë mbetet mungesa e kuadrit të trajnuar dhe profesional që kanë njohuri në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe veçanërisht ekspertë në fushën e shkencave të informatikës, të cilët janë kyç për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Agjencia në periudhën e ardhëshme do të vazhdojë me aktivitete për përf forcimin e statusit të saj të pavarur dhe autonom, veçanërisht në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe në sigurimin e fondeve të pavarura buxhetore përmes krijimit të kornizës rregullatore adekuate.

Në këtë kontekst, Agjencia do të vazhdojë me aktivitetet për miratimin e Propozim-ligjit të përgatitur për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në vitin 2024, i cili do të sigurojë që Agjencia të ketë burimet e nevojshme për kryerjen efektive të funksioneve dhe kompetencave të saj, me synim sigurimin e funksionimit të pavarur, autonom dhe të paanshëm siç parashikohet në Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave.



9. REKOMANDIME

Në periudhën që nga miratimi i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia ka arritur progres në drejtim të zbatimit të dispozitave të kornizës së re ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë, sipas Misionit vlerësues të Komisionit Evropian për organet e pavarura dhe rregullatore në Maqedoninë e Veriut dhe Udhërrëfyesin për sundimin e ligjit, Agjencia ka marrë rekomandimet e mëposhtme:

- Dispozitat kundërvajtëse të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të zbatohen në mënyrë rigorozë. Agjencia duhet të jetë e rreptë dhe të fillojë procedurë për kundërvajtje ndaj kontrolluesve/përpunuesve të të dhënave personale dhe ndaj personave fizik përgjegjës.

- Të miratojë Strategji për mbrojtjen e të dhënave personale me Plan veprimi shoqërues.

- Të forcojë dhe zbatojë sistematikisht aktivitetet edukative dhe ndërgjegjësuese të Agjencisë.

- Të forcojë bashkëpunimin me palët e ndryshme (publikun e gjerë, shoqërinë civile duke përfshirë organizatat joqeveritare, institucionet publike) me qëllim rritjen e aksesueshmërisë dhe ndërgjegjësimin në mënyrë sistematike.

- Të zbatojë aktivitete për përmirësimin e perceptimit publik dhe dukshmërisë së Agjencisë.

Rekomandimet e Misionit të vlerësimit u referohen gjithashtu autoriteteve dhe agjencive shtetërore:

- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të ndryshohet dhe të përpunohet më tej në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i tij në praktikë. Pas kësaj duhet të pasohet nga procesi në kohë të harmonizimit të të gjitha ligjeve të tjera që përmbajnë dispozita për përpunimin e të dhënave personale.

- Direktiva e policisë duhet të transponohet menjëherë në legjislacionin kombëtar.

- Të garantohen fonde të mjaftueshme për kryerjen efektive të detyrave dhe kompetencave të Agjencisë dhe pavarësinë e saj në shpenzimin e fondeve të alokuara në përputhje me detyrat dhe kompetencat e saj.

- Kapacitetet institucionale të Agjencisë duhet të përshtaten me numrin e parashikuar në sistematizimin dhe me detyrat dhe kompetencat e saj. Të sigurohen burime të mjaftueshme financiare për ta mbështetur këtë. Numri i të punësuarve që zotërojnë ekspertizë dhe njohuri të IT-së duhet të rritet me prioritet.

- Institucionet dhe organizatat duhet të konsultohen me Agjencinë gjatë përgatitjes së projekteve apo ligjeve të ndryshme që përfshijnë përpunimin e të dhënave personale dhe të ndjekin udhëzimet e tyre.

- Të përmirësohet pozicioni dhe roli i zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të harmonizohet me rregulloren ligjore.

Rekomandimet e përgjithshme ishin që:

- Duhet të vendosen fushata/iniciativa gjithëpërfshirëse të politikave që çojnë në përmirësimin e nivelit të transparencës në nivel kombëtar.

- Duhet të kryhen aktivitete ndërgjegjësuese për edukimin e popullatës për të drejtat e tyre në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Për të ndjekur këto rekomandime dhe për të zbatuar kuadrin ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, fokus kryesor i Agjencisë në periudhën e ardhshme do të jenë aktivitetet e mëposhtme:

- Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë për mbrojtjen e të dhënave personale 2024-2030;

- Miratimi dhe publikimi i Rregullores së re për sigurinë e përpunimit të të dhënave personale;


- Përgatitja e Strategjisë së Komunikimit 2024-2030;

- Promovimi i Metodologjisë për Harmonizimin e legjislacionit sektorial në lidhje me krijimin e vlerësimit të ndikimit të ligjeve nga aspekti i mbrojtjes së të dhënave personale



nga propozuesit (ministritë) me rastin e konceptimit të propozim-ligjeve që rregullojnë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, përdorimin dhe shpërndarjen e të dhënave personale;


- Forcimi i pozitës së zyrtarëve (oficerëve) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Miratimi dhe publikimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën e kryerjes së supervizionit;
- Miratimi dhe publikimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën e raportimit të cenimit të sigurisë së të dhënave personale;
- Miratimi dhe publikimi i akteve nënligjore në lidhje me transferimin e të dhënave personale.





10. SHTOJCAT

Shtocja nr. 1: Organogrami i Agjencisë deri më 31 Dhjetor 2023





Shtojca nr. 2: Përfaqësim i drejtë i të punësuarve

Përkatësia e komunitetit	F	M	Gjith.	Gjithsej
Shqiptarë	3	5	8	40,00%
Vlleh	0	1	1	5,00%
Maqedonas	7	4	11	55,00%
Gjithsej:	10	10	20	100,00%

Shtojca nr. 3: Struktura e të punësuarve sipas gjinisë

Përkatësia e komunitetit	A	B	M	Gjith.	Gjithsej
Femra	3	0	7	10	50,00%
Meshkuj	5	1	4	10	50,00%
Gjithsej:	8	1	11	20	100,00%

Shtojca nr. 4: Struktura e të punësuarve sipas moshës

Moshë	Gratë				Meshkuj				Gjith.	Gjithsej
	A	C	M	Gjith.	A	C	M	Gjith.		
18-25				0				0	0	0,00%
26-30				0				0	0	0,00%
31-35	2			2			1	1	3	15,00%
36-40			2	2	1		1	2	4	20,00%
41-45	1		2	3	1			1	4	20,00%
46-50				0	2			2	2	10,00%
51-55			2	2	1	1		2	4	20,00%
56-60			1	1			1	1	2	10,00%
61+				0			1	1	1	5,00%
Gjithsej:	3	0	7	10	5	1	4	10	20	100,00%

Shtojca nr. 5: Struktura sipas nivelit të arsimit

Shkalla e arsimit	Femra				Meshkuj				Gjith.	Gjithsej
	A	C	M	VK.	A	C	M	VK.		
ALP	3		6	9	3	1	3	7	16	80,00%
SHMO			1	1	2			2	3	15,00%
SHF				0			1	1	1	5,00%
Gjithsej:	3	0	7	10	5	1	4	10	20	100,00%

Shtojca nr. 6: Struktura sipas llojit të arsimit

Lloji i arsimit	Femra				Meshkuj				Gjith.	Gjithsej
	Sh	V	M	Gjith.	SH	V	M	Gjith.		
Dr.				0				0	0	0,00%
Mr.	1		1	2	1		1	2	4	20,00%
VII/1 ose VI A	1		5	6	2	1	2	5	11	55,00%
VIL	1			1				0	1	5,00%
SHMP			1	1	2			2	3	15,00%
SHF				0			1	1	1	5,00%
Gjithsej:	3	0	7	10	5	1	4	10	20	100,00%



Shtojca nr. 7: Struktura sipas titujve të nëpunësve administrativë dhe personave të emëruar/të zgjedhur

Kategoria	Femra				Meshkuj				Gj.	Gjithsej
	A	C	M	VK.	A	C	M	VK.		
Drejtor				0	1			1	1	5,00%
Zëvendësdrejtor				0				0	0	0,00%
Sekretar i përgjithshëm	1			1				0	1	5,00%
Këshilltar shtetëror				0		1		1	1	5,00%
Udhëheqës sektori			1	1			1	1	2	10,00%
Ndih. Udhëheqës sektori				0				0	0	0,00%
Udhëheqës njësie			3	3				0	3	15,00%
Këshilltar			2	2	2		2	4	6	30,00%
Bashkëpunëtorë i lartë	1			1				0	1	5,00%
Bashkëpunëtor				0				0	0	0,00%
Bashkëpunëtor i ri	1			1				0	1	5,00%
Referent i pavarur				0	1			1	1	5,00%
Referent i lartë				0				0	0	0,00%
Referent				0				0	0	0,00%
Referent i ri				0				0	0	0,00%
Nikoqir			1	1				0	1	5,00%
Personi teknik ndihmës (shofer)				0	1			1	1	5,00%
Higjienist				0			1	1	1	5,00%
Gjithsej:	4	0	6	10	5	1	4	10	20	100,00%

Shtojca nr. 8: Struktura sipas kategorive të titujve dhe personave të emëruar/zgjedhur

Titulli	Femra				Meshkuj				GJ.	Gjithsej
	A	C	M	VK.	A	C	M	VK.		
Drejtor				0	1			1	1	5,00%
Zëvendësdrejtor				0				0	0	0,00%
Udhëheqës	1		4	5		1	1	2	7	35,00%
Profesional	2		2	4	2		2	4	8	40,00%
Ndihmës-profesional				0	1			1	1	5,00%
Ndihmës-teknik			1	1	1		1	2	3	15,00%
Gjithsej:	3	0	7	10	5	1	4	10	20	100,00%

Shtojca nr. 9: Supervizione

Supervizione	Vepruar	Gjithsej supervizione
Supervizione të rregullta	27	27
Supervizione të jashtëzakonshme	210	210
Supervizione kontrolluese	237	237

Shtojca nr. 10: Supervizione sipas sektorëve të rregullta, të jashtëzakonshme dhe kontrolluese

Supervizione	Gjithsej
Sektori publik:	34
Sektori privat:	195
Persona fizik:	8
Gjithsej:	237



Shtojca nr. 11: Supervizione sipas fushave

Fusha	Të rregullta	Të jashtëzakonshme	Gjithsej
Financa	0	18	18
Komunikime elektronike	6	6	12
Ndërtimtari	0	1	1
Banimi	0	14	14
Institucione shtetërore	0	4	4
Energjetikë	0	4	4
Shëndetësi	0	3	3
Shoqata të qytetarëve	0	3	3
Industri	0	1	1
Vetëqeverisje lokale	21	2	23
Lotaria dhe lojërat e fatit	0	4	4
Arsimi	0	4	4
Autoritetet e zbatimit të ligjit	0	1	1
Postat	0	1	1
Gjyqësori	0	1	1
Tregtia	0	112	112
Turizëm dhe hoteleri	0	29	29
Kulturë dhe argëtim	0	2	2
Gjithsej:	27	210	237

Shtojca nr. 12: Supervizionet e jashtëzakonshme sipas mënyrës së parashtrimit të tyre

Kërkesa të qytetarëve	36
Iniciativa	19
Detyrë zyrtare	155
Gjithsej:	210

Aneksi nr. 13: Lista e propozim- ligjeve, akteve nënligjore dhe materialeve të tjera për të cilat është dhënë mendim

1.	Propozim-ligj për ndryshim dhe plotësim të ligjit për sistemin njësportel dhe për mbajtjen e regjistrit tregtar dhe regjistrit të personave të tjerë juridikë – Ministria e Ekonomisë
2.	Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje sociale – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
3.	Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë devizore – Ministria e Financave
4.	Propozim-ligj për revizion – Ministria e Financave
5.	Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për armët - Ministria e Punëve të Brendshme
6.	Propozim-ligj për regjistrimin e bujqësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2024 – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave
7.	Propozim-ligj për Prospektet dhe Detyrimet e Transparencës për Emetuesit e Letrave me Vlerë – Ministria e Financave
8.	Propozim-ligj për instrumentet financiare – Ministria e Financave
9.	Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrin Qendror – Ministria e Financave
10.	Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës policore dhe formën dhe përmbajtjen e formularit të evidencës policore – Ministria e Punëve të Brendshme



11.	Informacion mbi Kodin e Sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve – Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale
-----	---

Aneksi nr. 14: Lista e propozim-ligjeve që i janë dorëzuar Agjencisë për konsultim paraprak

1.	Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Drejtorinë e të hyrave publike – Drejtoria për të hyra publike
2.	Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje sociale – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
3.	Rregulla për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare të Maqedonisë - Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
4.	Vendim për punë devizore – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
5.	Vendim për dhënien e lejeve dhe pëlqimeve për operatorin e sistemit të pagesave dhe për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të operatorëve të sistemit të pagesave – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
6.	Propozim-ligj për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave - Ministria e Financave
7.	Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin me një ndalesë – Ministria e Ekonomisë

Shtojca nr. 15: Lista e sugjerimeve për organet e pushtetit qendror në lidhje me dispozitat dhe instrumentet e tjera ligjore

1.	Rregullore për mënyrën e paraqitjes së kërkesës, si dhe formën dhe përmbajtjen e kërkesës për marrjen ose rinovimin e miratimit për vendosjen në treg të aditivëve për ushqimin e kafshëve – Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
2.	Rregullore për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit të personave juridikë që importojnë ushqim për kafshë, si dhe formën dhe përmbajtjen e regjistrit të importuesve të ushqimit për kafshë – Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
3.	Rregullore për ndryshimin e Rregullores për kërkesat që duhet të plotësojnë subjektet për marrjen e lejes për menaxhimin e mbeturinave, formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për marrjen e lejes për menaxhimin e mbeturinave dhe mënyrën e paraqitjes së kërkesës, si dhe formën dhe përmbajtjen të formularit të lejes për veprimtarinë e menaxhimit të mbeturinave – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
4.	Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet më të afërta të regjistrimit në evidencën e grupit të veprimit lokal, procedurën e regjistrimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave
5.	Rregullore për formën dhe përmbajtjen e aplikacionit për prodhimin e lulëkuqes, librin e regjistrimit, kontratën e prodhimit, si dhe kriteret më të afërta për prodhimin e lulëkuqes dhe blerjen e lulëkuqes për prodhimin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujit
6.	Rregullore për formën dhe përmbajtjen e vendimit pas inspektimit – Ministria e Shoqërisë Informativë dhe Administratës
7.	Rregullore për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për dhënien e provimit për fitimin e statusit të kontabilistit dhe aplikimit për dhënien e provimit për fitimin e statusit të kontabilistit të autorizuar, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës për kontabilist dhe certifikatës për kontabilist i autorizuar – Ministria e Financave
8.	Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për regjistrim në regjistrin e kontabilistëve dhe kërkesës për regjistrim në regjistrin e kontabilistëve të autorizuar, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së përvojës së fituar në kryerjen e punëve për kontabilist- Ministria e Financave
9.	Rregullore për formën dhe përmbajtjen e procesverbalit të inspektimit financiar, formën dhe përmbajtjen e procesverbalit përfundimtar të inspektimit financiar kur subjektet e inspektimit financiar nuk kanë paraqitur vërejtje në letër, formën dhe përmbajtjen e procesverbalit përfundimtar të inspektimit financiar kur subjektet e inspektimit financiar kanë paraqitur në kohë vërejtjet në formë letre, por ato nuk pranohen nga inspektori financiar dhe forma dhe përmbajtja e procesverbalit



	përfundimtar të inspektimit financiar të kryer kur subjektet e inspektimit financiar kanë paraqitur vërejtje në flete me fakte dhe prova materiale të reja që kanë ndikim në ndryshimin e gjendjes faktike të përcaktuar në procesverbal dhe pranohen nga inspektori financiar – Ministria e Financave
10.	Rregullore për vlerësimin funksional – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
11.	Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit të të dhënave të personave të zgjedhur dhe të emëruar – Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
12.	Rregullore për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrimit të personave të zgjedhur dhe të emëruar – Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
13.	Rregullore për mënyrën dhe kushtet për përcaktimin e të ardhurave maksimale të rregulluara dhe tarifave mesatare të rregulluara për transmetimin e energjisë elektrike, organizimin dhe menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe shpërndarjen e energjisë elektrike – Komisioni Rregullativ për Energji, Shërbime të Ujit dhe Shërbime për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shtojca nr 16: Trajtimi i parashtresave

Trajtimi i parashtresave	Gjithsej
Personat fizikë	251
Personat juridikë	7
Gjithsej:	258


Shtojca nr. 17: Mënyra e parashtrimit të parashtresave

Mënyra e parashtrimit të parashtresave	Gjithsej
Në mënyrë elektronike	184
Me shkrim	74
Gjithsej:	258

Shtojca nr. 18: Parashtrimet sipas llojit të rrjeteve sociale

Pyetje sipas llojit të rrjeteve sociale	Gjithsej
Profili i rremë	115
Hakuar (profil i hakuar)	87
Shkelja e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve	10

Aneksi nr. 19: Regjistrimi i zyrtarëve (oficerëve) të rinj për mbrojtjen e të dhënave personale sipas vitit





Shtojca nr. 20: Pasqyrë e trajnimeve të realizuara nga Agjencia

Trajnime të realizuara nga Agjencia	Numri i trajnimeve	Pjesëmarrësit
Trajnime online përmes platformës Zoom	8	177
Ligjërimi: në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes	1	19
Gjithsej:	9	196

Shtojca nr. 21: Mendime /Rekomandime të dhëna në lidhje me transferimin e të dhënave personale në vende të tjera

Mendime/rekomandime të dhëna	Spektori	Gjithsej
Njoftimet, Mendime në lidhje me dokumentacionin dhe pyetje të përgjithshme në lidhje me transferimin e të dhënave personale në vendet e treta	Drejtësisë, bankar, sigurimit, arsimit, telekomunikacionit dhe prodhimit	15
Gjithsej:		15

Shtojca nr. 22: Fletëparaqitjet për transferimin e të dhënave personale në BE dhe Zonën Ekonomike Evropiane

Spektori	Vendi	Numri i fletëparaqitjeve
Bankar	Bulgaria	4
	Franca	1
	Gjermania	2
	Sllovenia	4
	Austria	1
	Holanda	1
Marrëdhënie pune	Gjermania	1
Çështje ligjore	Gjermania	1
Arsim	Gjermania	2
Tregti	Greqia	2
Prodhim	Belgjika	1
	Irlanda	1
	Gjermania	3
Sigurim	Austria	1
	Republika Çeke	1
Marketing	Bulgaria	1
	Gjermania	3
	Luksemburgu	1
Shëndetësi	Letonia	1
Teknologji e informacionit	Irlanda	1
	Kroacia	3
	Norvegjia	2
	Gjermania	2
Gjithsej:		40

Shtojca nr. 23: Kërkesa të pranuar për miratimin e transferimit të të dhënave personale

Spektori	Vendi	Te Miratuar	Te Refuzuar	Procedu ratë ndëprer a	Refuzura	Në vazhdimsi
Bankar	Bosnjë dhe Herecegovinë	1	/			/
Prodhimit	SHBA		/	1		




Arsimit	SHBA					1
Marketingut	Gjeorgji	1				
Teknologji të informacionit	Kosova	1				
Tregtisë	SHBA Serbi	1	/			1

Shtojca nr. 24: Mendimet, pyetjet dhe njoftimet për transferimin e të dhënave personale

Mendimet, pyetjet, njoftimet	Spektori	Numri i mendimeve
Njoftimet, mendimet në lidhje me dokumentacionin dhe pyetjet e përgjithshme në lidhje me transferimin e të dhënave personale në vendet e treta	Drejtësi , bankar , sigurim , arsim, marketingu, telekomunikacion dhe prodhim	19
Gjithsej:		19


Shtojca nr. 25: Buxheti dhe shpenzimet për vitin 2023

Përshkrim	Shuma/denarë
Buxheti i përgjithshëm për vitin 2023	17.305.000,00
Gjithsej shpenzime të realizuara	16.2 71.534,00





Shtoja nr. 26: Struktura e buxhetit të miratuar për vitin 2023




Shtojca nr. 27: Tabela krahasuese e buxhetit të miratuar për vitin 2023 me buxhet të miratuar për vitin 2022 (në denarë)

Zëri	Buxheti 2022	Buxheti 2023
401-Paga bazë	9.024.000,00	9.264.000,00
402-Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	3.496.000,00	3.596.000,00
404-Kompensimet	200.000,00	190.000,00
420-Udhëtimet dhe shpenzimet ditore	350.000,00	400.000,00
421-Shërbimet komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	2.100.751,00	1.974.000,00
423-Materiale dhe inventar i imët	300.000,00	400.000,00
424-Riparimet dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	400.000,00	400.000,00
425-Shërbimet me kontratë	250.000,00	436.000,00
426- Shpenzime të tjera aktuale	300.000,00	300.000,00
464-Transferime të ndryshme	330.000,00	165.000,00
465- Pagesa sipas dokumenteve ekzekutive	0,00	0,00
480-Blerje pajisjesh dhe makinerish	139.249,00	100.000,00



485-Investimet dhe aktivet jo financiare	100.000,00	80.000,00
Gjithsej:	16.990.000,00	17.305.000,00

Shtojca nr. 27-a: Paraqitje grafike



Nga të dhënat e paraqitura duket qartë se buxheti i miratuar i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023 është 315.000,00 denarë më i lartë në krahasim me vitin 2022, që vjen si pasojë e rritjes së pagave në mars 2023 në bazë të rritjes së pagës minimale dhe 10% rritje në shtator 2023 sipas Marrëveshjes kolektive për të punësuarit në sektorin publik.

Shtojca nr. 26: Pasqyrë e realizimit të mjeteve financiare sipas zërave në vitin 2023

Zëri	Buxheti 2023	Realizimi
401-Paga bazë	9.264.000,00	9.107.655,00
401-Paga themelore	3.596.000,00	3.549.115,00
402-Kontribute të sigurimeve shoqërore	190.000,00	190.000,00
404-Kompensime	400.000,00	306.533,00
420-Udhëtime dhe shpenzime ditore	1.974.000,00	1.765.715,00
421-Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	400.000,00	306.370,00
423-Materiale dhe inventar i imët	400.000,00	400.000,00
424-Riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme	436.000,00	236.753,00
425-Shërbime kontraktuale	300.000,00	199.374,00
426-Shpenzime të tjera aktuale	165.000,00	93.252,00
464-Transfere të ndryshme	100.000,00	48.354,00
480-Blerje pajisjesh dhe makinerish	80.000,00	68.422,00




485-Investime dhe mjete jo financiare

17.305.000,00

16.271.543,00

Shtojca nr. 28-a: Paraqitje grafike



Sipas rishikimit të realizimit të burimeve financiare për vitin 2023 krahasuar me buxhetin e miratuar për vitin 2023, duket qartë se niveli i realizimit të buxhetit të përgjithshëm është 94.03%, që paraqet një përqindje të lartë të realizimit të të njëjtit, si dhe planifikimi aktual i buxhetit për vitin 2023.

Buxheti i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023 në llogarinë 631 është planifikuar të jetë 3.500.000,00 denarë.

Shtojca nr. 29: Realizimi i buxhetit për vitin 2023 - LLOGARIA lloji 631

Përshkrim	Denarë
Buxheti i përgjithshëm i miratuar për vitin 2023	3.500.000,00
Gjithsej shpenzime të realizuara	93.932,00




Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bazë të trajnimeve për mbrojtjen e të dhënave personale për kontrolluesit dhe përpunuesit e interesuar të të dhënave personale gjatë vitit 2023 ka realizuar të hyra prej 1.003.000,00 denarë.

Shtojca nr. 30: Pasqyrë e realizimit të mjeteve financiare sipas zërave në vitin 2023

Zëri	Buxheti 2023	Realizimi
420-Udhëtime dhe shpenzime ditore	656.000,00	301.762,00
421-Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	1.069.650,00	32.135,00
423-Materiale dhe inventar i imët	80.000,00	22.233,00
424-Riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme	240.000,00	0,00
425-Shërbime kontraktuale	320.000,00	5.000,00
426-Shpenzime të tjera aktuale	320.000,00	11.717,00
480-Blerje pajisjesh dhe makinerish	1.095.350,00	1.035.460,00
485-Investimet dhe mjete jo financiare	600.000,00	0,00
Gjithsej:	4.381.000,00	1.408.307,00

Shtojca nr. 31: Buxheti i miratuar i të hyrave të parashikuara për vitin 2023





Nga buxheti përgjithshëm i miratuar i të hyrave të parashikuara të Agjencisë për vitin 2023 në vlerë prej 3.500.000,00 denarë janë realizuar 2,68% ose 93.932,00 denarë.

Sa i përket strukturës së mjeteve të realizuara, 69,75% e mjeteve i referohen zërit mallra dhe shërbime (materiale dhe inventar i imët, riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme për nevojat e Agjencisë), dhe 30,25% për blerje pajisjesh dhe makinerish.

Shtojca nr. 32: Pasqyrë e realizimit të mjeteve financiare sipas zërave në vitin 2023

Buxheti i miratuar për vitin 2023 (Ilogaria 631)	Buxheti 2023	Realizimi 2023
420-Udhëtim dhe shpenzime ditore 300.000 denarë	300.000,00	0,00
421-Shërbimet komunale ngrohje, komunikim dhe transport	250.000,00	49.405,00
423-Materiale dhe inventar i imët 200.000 denarë	200.000,00	0,00
424-Riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme 250.000 denarë	250.000,00	16.115,00
425-Shërbimet kontraktuale 300.000 denarë	300.000,00	0,00
426-Shpenzime tjera rrjedhëse 300.000 den	300.000,00	0,00
480-Blerje pajisje dhe makineri 1.200.000 denarë	1.200.000,00	28.412,00
483-Blerje të mobiljeve 300.000 denarë	300.000,00	0,00
485-Investimet dhe mjetet jo financiare 300.000 denarë	300.000,00	0,00
486- Blerja e automjeteve 100.000 denarë	100.000,00	0,00
Gjithsej:	3.500.000,00	93.932